



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 53/2021 regjistër (JR)  
Datë 09.09.2021

Vendim nr. 41 (JR)  
Datë 05.10.2023

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 05.10.2023, ditën e enjte, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Kreshnik Omari, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 412, datë 06.07.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 62 e vijues.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Kreshnik Omari (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) vendosi mbylljen e hetimit administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Kreshnik Omari, vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe në përfundim të procesit të rivlerësimit konkludoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurive të deklaruara, pasi ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë dhe bazuar në pikat 1, 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 412, datë 06.07.2021, vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Kreshnik Omari, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

### II. Ankimi i subjektit të rivlerësimit

3. Ndaj vendimit nr. 412, datë 06.07.2021, të Komisionit, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit duke kërkuar prishjen e vendimit të Komisionit dhe urdhërimin e tij të vazhdojë kryerjen e procesit të rivlerësimit për kriteret e kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale. Ankimi i subjektit të rivlerësimit përmban shkaqe me natyrë procedurale dhe shkaqe lidhur me themelin e çështjes për kriterin e vlerësimit të pasurisë.
4. Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale konsistojnë në mënyrë të përmbledhur: (i) në interpretimin e gabuar nga ana e Komisionit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke e cilësuar vendimmarrjen mbi një kriter rivlerësimi, paragjykses e joligjor; dhe (ii) abuzimin me nocionin e barrës së provës së parashikuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me nivelin e provueshmërisë së provave.
5. Shkaqet e ankimit, mbi themelin e çështjes për kriterin e vlerësimit të pasurisë, paraqiten si më poshtë.

**5.1. Për pasurinë, shtesë anësore me sipërfaqe 48,6 m<sup>2</sup> e apartamentit me sipërfaqe 74 m<sup>2</sup> të ndodhur në “{\*\*\*}”**

**5.1.1.** Komisioni gabimisht bazohet në faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2013 blerjen e parcelës ndërtimore me sipërfaqe 16,2 m<sup>2</sup> dhe marrjen e lejes së legalizimit për shtesën anësore nga ALUIZNI. Në këndvështrim të subjektit të rivlerësimit, deklarohet pasuria e paluajtshme për të cilën gëzon cilësinë e pronarit apo bashkëpronarit dhe që të kesh këtë cilësi, duhet që pasuria të jetë e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

## 5.2. *Për pasurinë, garazh me sipërfaqe 11,5 m<sup>2</sup>*

5.2.1. Komisioni nuk arsyeton mosmarrjen parasysh të kërkesës së subjektit të rivlerësimit se në kushtet e ekzistencës së një kontrate sipërmarrjeje të vitit 2005, çmimi i tregut të kësaj pasurie të konsiderohej sipas çmimeve të referencës së këtij viti.

5.2.2. Pamundësia financiare e konstatuar nuk qëndron, pasi Komisioni nuk ka marrë në konsideratë gjendjen *cash* prej 135.000 eurosh që subjekti i rivlerësimit ka pasur në banesë deri në prill 2015, kur ka çelur depozitën bankare. Nga vetë Komisioni në vendim pranohet se subjekti i rivlerësimit ka sjellë nga puna në emigracion të paktën 40.000 euro, ka kursyer nga puna si gjyqtar deri në vitin 2003 shumën 1.000.000 lekë dhe, më tej, nga viti 2003 deri në vitin 2013 ka pasur shtim të *cash*-it nga puna si gjyqtar dhe nga ish-bashkëshortja të paktën shumën 3.081.560 lekë.

5.2.3. Në analizën financiare të vitit 2013, shpenzimet për legalizimin e shtesës anësore gabimisht janë llogaritur 83.696 lekë, ndërkohë që janë 74.996 lekë, nga të cilat vetëm 37.498 lekë janë paguar nga subjekti i rivlerësimit dhe pjesa tjetër është paguar nga nëna e tij, si bashkëpronare.

## 5.3. *Për pasurinë automjet tip "Lancia Thesis"*

5.3.1. Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë dhe ka mungesë burimesh financiare për blerjen e kësaj pasurie është i gabuar, pasi subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, si blerjen e automjetit, ashtu edhe çmimin faktik të tij.

5.3.2. Komisioni nuk arsyeton mospranimin e shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit se znj. V. P. ia shiti automjetin më lirë nga sa e kishte blerë, për shkak të marrëdhënies miqësore të tyre. Komisioni lë pa arsytuar, gjithashtu, përfundimin se znj. V. P. me veprimet e saj ka ndihmuar subjektin për të fshehur vlerën reale të automjetit. Nëse mund të aludohet se ajo e ka bërë këtë për shkak të marrëdhënies së tyre, atëherë përse nuk vlen ky shkak edhe për faktin që ajo ka dashur t'i bëjë atij një dhuratë.

5.3.3. Kjo situatë mund të kualifikohet si mosdeklarim i dhuratës së bërë nga znj. V. P. në deklaratën periodike vjetore 2013, dhe shkak i mungesës së vëmendjes në përpilimin e saktë të kësaj deklarate mund të ketë qenë fakti se nga blerja e automjetit deri në plotësimin e saj kishte kaluar mbi një vit, si dhe pasojat dhe stresi i divorcit të subjektit të rivlerësimit.

## 5.4. *Për pasurinë velierë, me gjatësi 9 metra*

5.4.1. Konkluzioni i Komisionit për pamundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit nuk qëndron. Komisioni nuk merr në konsideratë gjendjen *cash* që subjekti ka pasur në banesë deri në prill 2015.

5.4.2. Pasaktësinë në deklaram për velierën, Komisioni e argumenton gabimisht edhe me faktin se nga nëna e subjektit është marrë me qira në datën 12.04.2016 një apartament dhe një vend varke në Marinën e Orikumit, Vlorë, duke argumentuar se [...] *subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i sinqertë dhe bashkëpunues me Komisionin, lidhur me deklarimet e bëra prej tij. Duket se pikërisht në këtë periudhë ka porositur (parapaguar) edhe vendparkimin.* Marrja me qira e

apartamentit nga nëna ka filluar në vitin 2007 dhe jo në vitin 2016, si dhe nuk ka asnjë lidhje logjike me saktësinë e çmimit apo me blerjen e velierës.

**5.4.3.** Komisioni arrin në konkluzione të paargumentuara dhe pavarësisht provave të paraqitura nga subjekti konkludon se ai nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës pa arsyetuar mosmarrjen parasysh të argumenteve të subjekti i rivlerësimit edhe përse mbi to prevalojnë ato të Komisionit.

#### **5.5. *Për pasurinë depozitë bankare në shumën 135.019 euro***

**5.5.1.** Konkluzioni i Komisionit, lidhur me pamundësinë financiare me burime të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për krijimin e depozitës, është i gabuar.

**5.5.2.** Nga puna në emigracion në Itali dhe provat e vëna në dispozicion, Komisioni ka njohur vetëm shumën 76.064.077 lireta italiane kundrejt shumës 167.862.348 lireta italiane. Komisioni ka një gabim në përlllogaritje, pasi shuma në zarfet e pagave mujore rezultojnë 77.006.865 lireta italiane, dhe kjo shumë në fakt nuk përfaqëson të ardhurat e plota të përfituara, por vetëm 60-70% të pagës së përfituar efektivisht, e që në mënyrë të padrejtë nuk është marrë parasysh në analizën financiare të kryer nga Komisioni.

**5.5.3.** Komisioni nuk ka llogaritur pagesat e shënuara në fletët e verdha që shoqëronin zarfet e pagave në kompaninë të transportit dhe dërgesave “{\*\*\*}” që përfaqësonin pagesat për orët jashtë orarit, transfertat dhe punën e kryer të shtunë dhe të diel, që arrinin në total vlerën 24.892.000 lireta italiane.

**5.5.4.** Komisioni nuk ka marrë parasysh faktin që për të paktën tre muaj nëpërmjet disqeve të tahografit që regjistrojnë shpejtësinë e kamionit, orët e punës, si dhe kilometrat e përshkruara, mund të provohet punësimi në kompaninë “{\*\*\*}” Napoli. Nga Komisioni nuk janë marrë parasysh një sërë faktesh, të cilat nuk janë përmendur as në vendim, ndërkohë që Komisioni duhej të kundërshtonte pretendimet e subjektit të rivlerësimit.

**5.5.5.** Lidhur me të ardhurat e ish-bashkëshortes, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë deklaratimet në deklaratën periodike vjetore 2007. Deklarata noteriale e ish-bashkëshortes, sipas Komisionit, jep të dhëna vetëm për të ardhurat dhe jo për fitimin e realizuar dhe pavarësisht se nga vërtetimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, rezultojnë se ish-bashkëshortja për vitin 2007 ka deklaruar nivelin e qarkullimit vjetor/xhiro 0-2.000.000 lekë dhe ka likuiduar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore në shumën 29.050 lekë, Komisioni pretendon të kundërtën.

**5.5.6.** Nga njëra anë, Komisioni njeh si të ligjshme depozitat e babait të subjektit të rivlerësimit në shumën 1.000.000 lekë dhe 500.000 lekë dhe nga ana tjetër nuk njeh si kursim *cash* shumën 700.000 lekë që subjekti ka trashëguar prej tij.

#### **5.6. *Lidhur me transaksionet e kryera nga prindërit e subjektit të rivlerësimit***

**5.6.1.** *Për apartamentin dhe vendvarke në Orikum, Vlorë, kontraktuar nga nëna e subjektit*

a) Komisioni, pa u mbështetur në asnjë provë dhe pa arsyetuar, hedh poshtë analizën financiare të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit dhe arrin në konkluzionin se kjo është pasuri e fshehur e tij.

b) Subjekti i rivlerësimit nuk ka detyrimin të provojë burimin e krijimit të pasurisë së prindërve të tij në përgjithësi dhe në rastin konkret të nënës, në kushtet e mungesës së marrëdhënies së interesit mes tyre. Analiza financiare e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit provon se nëna e tij ka qenë në gjendje të përballonte shpenzimin.

c) Komisioni nuk merr parasysh vërtetimin e lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, mbi pagesat e kryera nga nëna e subjektit të rivlerësimit, me argumentin se ky dokument nuk u paraqit nga noterja gjatë hetimit administrativ në Komision, ndërkohë që dokumenti i paraqitur është nxjerrë nga arkiva e saj.

d) Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës pa bërë asnjë kundërgargumentim me prova se përse nuk merren parasysh argumentet e dhëna prej tij dhe përse ato të Komisionit prevalojnë.

#### 5.6.2. *Për apartamentin me sipërfaqe totale 134,40 m<sup>2</sup> ndodhur në “{\*\*\*}”, Tiranë*

a) Komisioni nuk argumenton se mbi cilat nga faktet e renditura në vendim arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit fsheh pjesën e tij takuese në këtë pasuri, përpiqet të shmangë dhënien e shpjegimeve lidhur me burimin e krijimit të saj, si dhe mbi cilat prova vërteton se subjekti i rivlerësimit ishte në dijeni të krijimit të kësaj pasurie.

b) Komisioni nuk argumenton se përse çmimi favorizues i blerjes së këtij apartamenti lidhet me subjektin e rivlerësimit.

c) Komisioni nuk jep asnjë argument se në çfarë mënyre origjina e të ardhurave të përdorura, mosha e nënës së subjektit të rivlerësimit dhe çmimi i shitjes së kësaj pasurie provojnë se është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit.

d) Nuk mund të konsiderohet argument ligjor pohimi hipotetik i Komisionit se nga hetimi administrativ duket se kjo pasuri i takon subjektit të rivlerësimit në masën 50%, dhe se do të jetë trashëgimtar i kësaj pasurie në vijim, pasi askush nuk mund ta dijë çfarë do të ndodhë në vijim se cili do të jetë trashëgimtar i kujt.

e) Komisioni pohon se kjo pasuri është krijuar pas deklaratës së pasurisë *vetting* e në këtë rast natyrshëm të lind pyetja, a mundet që dikush që kërkon të fshehë një pasuri të kryejë transaksione që do të çonin në zbulimin e kësaj pasurie, pikërisht gjatë kohës së rivlerësimit. Nga të gjitha provat e renditura nga vetë Komisioni, rezulton pa asnjë dyshim se apartamenti është porositur dhe paguar nga nëna e subjektit të rivlerësimit, me paratë që i përkasin asaj.

f) Komisioni arrin në konkluzione të pambështetura në prova dhe pavarësisht argumenteve të subjektit të rivlerësimit konkludon se ai nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, pa arsyetuar (me prova) mosmarrjen parasysh të këtyre argumenteve.

#### 5.6.3. *Për dy vendparkime ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, kontraktuar nga babai i subjektit të rivlerësimit*

a) Dyshimi i Komisionit, lidhur me kontratën premtim shitje të kësaj pasurie, është absolutisht i gabuar, paragjykes dhe tendencioz. Komisioni nuk përmend se çfarë dokumenti provues duhet të paraqesë subjekti i rivlerësimit për diçka që nuk ekziston.

b) Pa asnjë argument, Komisioni shprehet se ka krijuar bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë bashkëpunues dhe nuk ka ndihmuar lidhur me këto pasuri, rrethana të cilat nuk ekzistojnë. Komisioni jep konkluzione të pambështetura në prova dhe pavarësisht argumenteve të paraqitura konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, pa arsyetuar me prova se përse nuk merren parasysh argumentet e dhëna nga subjekti dhe përse ato që pohon Komisioni duhet të konsiderohen të mirëqena.

### III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

#### A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

##### a) Juridiksioni i Kolegjit

6. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Kreshnik Omari, vendim të cilin nëpërmjet ankimit subjekti i rivlerësimit kërkon ta prishë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas parashikimit të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016.

##### b) Legjitimimi i ankuesit

7. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

##### c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

8. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 412, datë 06.07.2021, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Kreshnik Omari, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi.
9. Në fillim të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, trupi gjykues i Kolegjit mori në analizë shkaqet e ankimit me natyrë procedurale të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, për të vlerësuar nëse ishte i nevojshëm debati gjyqësor, për korrigjimin e ndonjë shkelje të rëndë procedurale të Komisionit apo me qëllim konstatimin e saktë, të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike të çështjes, në kuptim të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar. Në vijim, trupi gjykues analizon shkaqet procedurale të ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim.

**9.1.** Subjekti i rivlerësimit ngre pretendimin se vlerësimi vetëm mbi bazën e kriterit të vlerësimit pasurisë është paragjykes e jo ligjor dhe vjen në kundërshtim me nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Komisioni nuk pranoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit, për kryerjen e vlerësimit mbi bazën e të tria kriterëve, me argumentin se *deri në këtë fazë të hetimit konstatohen problematika lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, për të cilin i ka kaluar barrën e provës për të dhënë shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.* Arsyetimi mbi nocionin e barrës së provës, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk afekton parashikimin ligjor se procesi i rivlerësimit duhet të kryhet mbi bazën e të tria kriterëve. Vendimmarrja e Komisionit mund të bazohet edhe vetëm mbi një kriter, por mbasi të ketë bërë një vlerësim të përgjithshëm të tri kriterëve. Ligji në këtë drejtim është i qartë e nuk lë vend për interpretime.

**9.1.1.** Kolegji e ka analizuar gjerësisht këtë shkak ankimor në jurisprudencën e tij. Kryerja e hetimit administrativ vetëm për një kriter ka për qëllim ekonominë gjyqësore dhe nuk duhet perceptuar si paragjykim i procesit të rivlerësimit. Vetë dispozita ligjore e përmendur nga subjekti i rivlerësimit e lejon, si dhe legjitimohet nga dispozitat e tjera të ligjit nr. 84/2016, konkretisht neni 52, pika 2 dhe neni 59, pika 1, ku i pari parashikon se: *“Nëse Komisioni ose Kolegji i Apelit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45, të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën”.* Në rastin konkret, Komisioni ka vlerësuar se provat për kriterin e vlerësimit të pasurisë kanë arritur nivelin e provueshmërisë. Nëse subjekti do të kishte provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ, atëherë Komisioni do të kishte detyrimin ligjor për të vijuar me vlerësimin e dy kriterëve të tjerë për të arritur në një vendimmarrje, pasi është vetë neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, që kërkon nivel të besueshëm/kualifikues në të tria kriteret së bashku për të konfirmuar subjektin e rivlerësimit në detyrë. Në këto kushte, konkluzioni mbi pamjaftueshmërinë e deklaramit të pasurisë është i mjaftueshëm për të konkluduar në masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, i interpretuar gjerësisht në praktikën e Kolegjit.

**9.2.** Nga përmbajtja e vendimit të Komisionit, sipas subjektit të rivlerësimit, është lehtësisht e konstatuashme se është abuzuar me nocionin e barrës së provës, parashikuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, referuar të cilit subjektit të rivlerësimit i kalohet barra e provës kur Komisioni arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, ndërkohë që për të gjitha pasuritë, për të cilat i është kaluar barrë prove, Komisioni nuk është mbështetur në prova, por thjesht ka renditur disa fakte dhe ka dhënë konkluzion pa arsyetim mbështetës, është mjaftuar me pohime të paargumentuara, pavarësisht se ligji kërkon që konkluzionet duhet të jenë, jo vetëm të bazuara në prova, por edhe të kenë nivelin e provueshmërisë.

**9.2.1.** Në përgjigje të këtij pretendimi, nga analizimi i rezultateve të hetimit administrativ përcjellë subjektit të rivlerësimit në kuadër të barrës së provës, trupi gjyqësor konstaton se janë evidentuar informacionet e ekstraktuara nga aktet shkresore të administruara në Komision, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorëve, si dhe konstatimet përkatëse, për të cilat Komisioni i ka ngarkuar subjektin të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën, për secilën nga pasuritë e tij apo të prindërve.

**9.2.2.** Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, duket që Komisioni konkluzionin e tij e ka mbështetur, gjithashtu, në faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe arsyetimin e tij të bazuar në prova. Për disa gjetje të Komisionit, kryesisht pasuri në emër të nënës dhe të babait të subjektit të rivlerësimit, ky i fundit është shprehur se nuk kanë lidhje me të ose nuk ka qenë në dijeni, ashtu siç do të trajtohen më poshtë në këtë vendim. Vendimi i Komisionit është bazuar në aktet e administruara, që kishin arritur nivelin e provueshmërisë, e për të cilat duket që subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën. Në këto kushte, pretendimi i tij është i pabazuar.

**9.3.** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se të ardhurat që nuk njihen nga Komisioni janë krijuar në disa raste nga puna informale ose nga diferenca ndërmjet pagesës së formalizuar dhe asaj faktike. Vetë ligji nr. 84/2016 në nenin 61 të tij, duke pasur parasysh pikërisht informalitetin, ka parashikuar që subjekti i rivlerësimit shkarkohet nga detyra nëse ka deklaruar më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme.

**9.3.1.** Në analizë të këtij shkak ankimor, trupi gjykues vëren se vendimi për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit nuk është bazuar në nenin 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, që lidhet me deklarin më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, por subjekti i rivlerësimit është gjetur në kushtet e nenit 61, pika 3 të këtij ligji, pasi ka bërë deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë. Secili paragraf i nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 përbën një shkak të pavarur për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Në këto kushte, objekt i analizës në Kolegj është vlerësimi nëse konkluzioni i arritur nga Komisioni se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 është i drejtë ose i gabuar. Në vijim të këtij arsyetimi, si dhe mbështetur në jurisprudencën<sup>1</sup> e Kolegjit, trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit.

- 10.** Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti prova të reja në ankim, si dhe në përfundim të analizimit të shkaqeve me natyrë procedurale të ngritura, trupi gjykues vlerëson që Kolegji nuk ndodhet në rastet e parashikuara nga neni F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, që do të legjitimonin shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, në kuptim të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar. Në këto kushte, çështja (JR) nr. 53/2021, datë 09.09.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Kreshnik Omari, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, u shqyrtua në bazë dokumentesh<sup>2</sup> në dhomë këshillimi, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

## **B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë**

*B/1. Për pasurinë, shtesë anësore me sipërfaqe 48,6 m<sup>2</sup> e apartamentit me sipërfaqe 74 m<sup>2</sup> të ndodhur në “{\*\*\*}”*

- 11.** Komisioni, për këtë pasuri, ka arritur në konkluzionin se deklarimi i subjektit nuk është i saktë edhe në përputhje me ligjin, pasi nuk ka deklaruar procesin e legalizimit dhe të drejtat reale mbi këtë pasuri të fituar në këtë proces. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se pasuria nuk

<sup>1</sup> Shih, ndër të tjera, vendimin (JR) nr. 19, datë 26.07.2019, paragrafi 22.15 dhe vendimin nr. 39, datë 25.09.2023, paragrafi 16.1, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

<sup>2</sup> Referuar akteve të dosjes së përcjellë në Kolegj nga Komisioni.



ishite regjistruar e, për këtë arsye, nuk ishte deklaruar, duken tërësisht të karakterit teknik dhe nuk ndikojnë në fitimin e të drejtave reale mbi këtë pasuri, si dhe deklarimin e shpenzimeve të kryera.

12. Subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë konkluzion, duke pretenduar se Komisioni gabimisht bazohet në faktin se nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2013 blerjen e parcelës ndërtimore me sipërfaqe 16,2 m<sup>2</sup> dhe marrjen e lejes së legalizimit nga ALUIZNI. Në këndvështrim të subjektit të rivlerësimit, deklarohet pasuria e paluajtshme për të cilën gëzon cilësinë e pronarit apo bashkëpronarit dhe që të kesh këtë cilësi, duhet që pasuria të jetë e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

13. Nga analizimi i akteve të dosjes së Komisionit, lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues konstaton se:

13.1. Pasuria, shtesë anësore është ndërtuar në apartamentin me sipërfaqe 74 m<sup>2</sup>, ndodhur në “{\*\*\*}”, Tiranë, përfituar nëpërmjet kontratës për privatizimin e banesës në datën 23.07.1993. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar shtesën anësore, si në deklaratën e pasurisë *vetting*, ashtu edhe në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie 2003. Sipas këtyre deklaratave dhe akteve të administruara rezulton se shtesa anësore është ndërtuar nga babai i subjektit të rivlerësimit, i cili, pasi është njohur pronar i saj, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 14.05.1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ia ka dhuruar subjektit të rivlerësimit nëpërmjet kontratës së dhurimit nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 09.01.1997. Meqë ndërtimi kishte përfunduar përpara se të përfundonte procedura e dhënies së lejes së ndërtimit, babai i subjektit të rivlerësimit, për të paguar detyrimet ndaj shtetit, si dhe për të pasur një regjim më ligjor të pasurisë nëpërmjet marrjes së lejes së legalizimit, këtë pasuri ia nënshtroi dhe procedurës së legalizimit të ndërtimit nga ALUIZNI<sup>3</sup>. Procedura e legalizimit përfundoi pas vdekjes së babait të subjektit dhe leja e legalizimit nr. {\*\*\*}, datë 18.04.2013, u lëshua në emër të subjektit të rivlerësimit dhe nënës së tij.

13.2. Nga dokumentacioni i përcjellë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës<sup>4</sup>, rezulton se më datë 15.04.2013, nënshkruhet kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., mes ALUIZNI-t në cilësinë e shitësit dhe blerësve Kreshnik Omari dhe E. O., për blerjen e parcelës ndërtimore me sipërfaqe prej 16,2 m<sup>2</sup>, në vlerën 54.108 lekë. Blerja e parcelës ndërtimore dhe marrja e lejes së legalizimit nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore 2013. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, më 27.05.2013, ishte njoftuar se nuk mund të pajisej me dokument pronësie deri në përfundim të regjistrimit të zonës kadastrale {\*\*\*} në sistem. Ky regjistrim, sipas tij, u krye në shtator 2019 dhe deklarimi u krye në deklaratën periodike vjetore të atij viti.

13.3. Për t’iu përgjigjur pretendimit të subjektit të rivlerësimit se deklarohet pasuria e paluajtshme për të cilën gëzon cilësinë e pronarit apo bashkëpronarit dhe që të kesh këtë cilësi duhet që pasuria të jetë e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, trupi gjykues vlerëson se në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka fituar disa të drejta reale mbi këtë

<sup>3</sup> Akronim për Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale.

<sup>4</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 11.02.2020.

pasuri, si dhe ka kryer shpenzime për krijimin e saj, në kuptim të nenit 4, shkronja “a” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ka pasur detyrimin të deklarojë blerjen e parcelës ndërtimore dhe legalizimin e shtesës anësore në deklaratën periodike vjetore 2013. Megjithatë, në kushtet kur pasuria është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe për të Komisioni nuk ka konstatuar mungesë të burimeve financiare të ligjshme, trupi gjykues vlerëson se problematika e mosdeklarimit në deklaratën periodike vjetore nuk ka peshë në procesin e rivlerësimit.

13.4. Subjekti i rivlerësimit në ankim ka sjellë në vëmendje se Komisioni është i paqartë për këtë pasuri, pasi në poshtëshënim nr. 1 dhe nr. 2, faqe 3 e vendimit objekt shqyrtimi i referohet nenit 33, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 41 të vendimit nr. 2, datë 18.01.2017, të Gjykatës Kushtetuese, të cilat nuk kanë lidhje me shtesën anësore. Trupi gjykues konstaton se ky pretendim nuk qëndron, pasi poshtëshënimi në faqen 3 të vendimit objekt shqyrtimi i referohet procedurës së rivlerësimit të Komisionit dhe jo shtesës anësore. Në paragrafin 15 të vendimit, Komisioni shprehet se *pavarësisht se sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është autoriteti përgjegjës për kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë për subjektet e rivlerësimit, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni kryen një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi. Me fjalë të tjera, pavarësisht se ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në përfundimin të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Kreshnik Omari, në raportin<sup>5</sup> e përgatitur konstatoi se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe ka mungesë dokumentacioni ligjor; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave, Komisioni, në kuadër të funksionit të tij kushtetues, kryen një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohet dhe as nuk është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga ILDKPKI-ja.*

*B/2. Për pasurinë, garazh me sipërfaqe 11,5 m<sup>2</sup>*

14. Për këtë pasuri, Komisionit i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare në vlerën (-) 1.441.290 lekë. Komisioni ka mbajtur në konsideratë çmimin e kësaj pasurie, referuar çmimit të referencës, duke e konsideruar deklarimin e subjektit të rivlerësimit të rremë. Sipas vlerësimit të Komisionit, subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të tij dhe se provat e paraqitura prej tij gjatë hetimit administrativ nuk gjenin mbështetje në deklaratimet periodike vjetore dhe sfidonin logjikën.
15. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit, duke pretenduar se: (i) në vendim nuk ka arsyetuar mosmarrjen parasysh të kërkesës së subjektit se, në kushtet e ekzistencës së një kontratë sipërmarrjeje të vitit 2005, çmimi i tregut të kësaj pasurie të konsiderohej sipas çmimeve të referencës së këtij viti; (ii) pamundësia financiare e konstatuar nuk qëndron, pasi Komisioni nuk ka marrë në konsideratë gjendjen *cash* prej 135.000 eurosh që subjekti i rivlerësimit ka pasur në banesë deri në vitin 2015, kur ka çelur depozitën bankare.

<sup>5</sup> *Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 31.08.2018, e ILDKPKI-së, me lëndë: “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Kreshnik Omari, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë”.*

Nga vetë Komisioni në vendim pranohet se subjekti i rivlerësimit ka sjellë nga puna në emigracion të paktën 40.000 euro, ka kursyer nga puna si gjyqtar deri në vitin 2003 shumën 1.000.000 lekë dhe, më tej, nga viti 2003 deri në vitin 2013, ka pasur shtim të *cash*-it nga puna si gjyqtar dhe nga ish-bashkëshortja të paktën shumën 3.081.560 lekë; (iii) në analizën financiare të vitit 2013, shpenzimet për legalizimin e shtesës anësore gabimisht janë llogaritur 83.696 lekë, ndërkohë që janë 74.996 lekë, nga të cilat vetëm 37.498 lekë janë paguar nga subjekti i rivlerësimit dhe pjesa tjetër është paguar nga nëna e tij, si bashkëpronare.

16. Nga analizimi i akteve të dosjes së Komisionit lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues konstaton, si vijon.

16.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi, garazh me sipërfaqe 11,5 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, blerë më datë 01.10.2013, në vlerën 2.725 euro, me burim nga të ardhurat. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën periodike vjetore 2013, pa deklaruar burimin e krijimit.

16.2. Kjo pasuri u përfitua me kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 01.10.2013, nëpërmjet të cilës shoqëria “{\*\*\*}” ShPK i shet z. Kreshnik Omari garazhin me sipërfaqe 11,5 m<sup>2</sup> të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, në shumën 2.725 euro. Referuar përcaktimeve në nenin 2 të kontratës, *shitësi deklaroi se çmimi i shitjes është shlyer plotësisht nga blerësi në zyrën noteriale në praninë e noterit.*

16.3. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit sqaroi se garazhin, i cili ndodhet 400 metra (5 minuta në këmbë) larg banesës, e ka blerë për të parkuar automjetin “Lancia Thesis” e blerë në vitin 2013, si mundësia më e afërt, pasi në qendër të Tiranës, “{\*\*\*}” ku ai banon, nuk ka shumë ndërtime të reja me vende parkimi. Çmimi prej 2.725 eurosh është prenotuar në vitin 2005 dhe, për këtë arsye, duhet të merren në konsideratë çmimet e referencës të atij viti. Gjithashtu, sipas subjektit të rivlerësimit, duhet mbajtur parasysh fakti se garazhi nuk është i mbyllur, por vendparkim i hapur në katin (-) 1 (një) të pallatit. Me shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit paraqet: (i) kontratë sipërmarrje, datë 15.04.2005, e cila nuk është noteriale, nënshkruar mes sipërmarrësit dhe investitorit shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe porositesit Kreshnik Omari, me objekt vendparkimin e ndodhur në katin (-) 1, me sipërfaqe 11,5 m<sup>2</sup>, në vlerën 2.725 euro, e cila do të paguhet *cash* në momentin e lidhjes së kontratës përfundimtare; (ii) vërtetim, datë 18.06.2021, të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, sipas së cilit z. Kreshnik Omari ka lidhur në vitin 2005 pranë shoqërisë një kontratë sipërmarrjeje për blerjen e një garazhi me sipërfaqe 11,5 m<sup>2</sup> dhe me shlyerjen e detyrimit financiar është lidhur kontrata e shitjes në vitin 2013. Ky garazh është shitur përafërsisht me çmim të njëjtë edhe me garazhe të tjera në këtë objekt; (iii) 4 (katër) kontrata shitje<sup>6</sup> me objekt shitje garazh me sipërfaqe 11,50 m<sup>2</sup>, në vlerën 2.725 euro, 2.850 euro ose 2.500 euro; (iv) 2 (dy) kontrata sipërmarrje/porosie<sup>7</sup>.

<sup>6</sup> Kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.12.2013, me blerës S. G.; kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.01.2014, me blerës M. O.; kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.04.2014, me blerës D. H.; kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.05.2015, me blerës A. S.; kontratë shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.05.2015, me blerës R. S..

<sup>7</sup> Kontratë sipërmarrje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 13.01.2012, mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe porositesit D. H., për garazh me sipërfaqe; kontratë porosie nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.09.2011, me porosites A. S..

16.4. Në vlerësim të trupit gjykues, çmimi prej 2.725 eurosh i përcaktuar në kontratën e shitjes është dukshëm i ulët në raport me vlerën 1.096.410 lekë të përcaktuar në kartelën e pasurisë së paluajtshme përcjellë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 02.06.2020, nga ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, përcaktuar në kuadër të aplikimit për rivlerësimin e pasurisë më datë 30.10.2013. Depozitimi i kontratës së sipërmarrjes të vitit 2005 (jonoteriale) nga subjekti i rivlerësimit, vetëm pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, e bën të pabesueshme vlerën provuese të saj, për më tepër kur asnjë nga kontratat e ngjashme (porosie/sipërmarrje) të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk është nënshkruar në vitin 2005, por vite më vonë, konkretisht në vitet 2011 dhe 2012. Megjithatë, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka depozituar kontrata të ngjashme shitjeje, të cilat përmbajnë të njëjtin çmim për pasuri me të njëjtën sipërfaqe të ndodhura në të njëjtin objekt, si dhe për vetë karakteristikat e garazhit si vendparkim i hapur, me kosto e vlerë tregu të ndryshme nga ai i apartamentit, bëjnë që trupi gjykues në ndryshim nga Komisioni të mos aplikojë ndaj subjektit të rivlerësimit nenin 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016, për deklaram të rremë të pasurisë, por të verifikojë mundësinë financiare të tij për krijimin e kësaj pasurie.

16.5. Në këtë drejtim, trupi gjykues i Kolegjit, duke reflektuar të njëjtat qëndrime me Komisionin nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrolloi analizën financiare të kryer prej tij në kuadër të verifikimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie duke e konsideruar çmimin sipas kontratës së shitjes, ashtu edhe sipas vlerës së rivlerësimit regjistruar në ZVRPP. Në përgjigje të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim, shpenzimet për legalizimin e shtesës anësore, në analizën financiare të vitit 2013, u pasqyruan sipas tarifave të paguara nga subjekti i rivlerësimit me urdhërzhirimet pranë “Credins Bank” ShA<sup>8</sup>. Sa i përket burimit të krijimit, subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* ka deklaruar “*të ardhurat*”, ndërkohë që në ankim pretendon që Komisioni nuk ka marrë në konsideratë kursimet *cash* prej 135.000 eurosh, gjendje në banesë deri në prill 2015. Trupi gjykues e gjen të pabazuar këtë pretendim, për arsye se, së pari ky burim krijimi nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe së dyti nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me pamjaftueshmëri financiare për krijimin e kursimeve në shumën 135.019 euro, trajtuar në vijim në këtë vendim. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit për periudhën 01.01.2013-01.10.2013, trupi gjykues konfirmon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 669.412 lekë për çmimin e garazhit sipas kontratës së shitjes dhe në vlerën (-) 1.380.507 lekë sipas vlerës së rivlerësimit në ZVRPP. Në të dyja rastet, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>8</sup> *Fatura përcjellë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 16.09.2012, e ZVRPP-së Tiranë, drejtuar ALUIZNI-t paguar në “Credins Bank” ShA: më 27.03.2013 në shumën 12.900 lekë, tarifa e shërbimit për legalizim firmosur nga Kreshnik Omari; më 27.03.2013, në shumën 6.300 lekë, tarifa e shërbimit për legalizim, firmosur nga Kreshnik Omari; më 27.03.2013, në shumën 8.268 lekë, taksë ndikimi në infrastrukturë, firmosur nga Kreshnik Omari; më 27.03.2013 në shumën 55.108 lekë, pagesë për parcelën ndërtimore, firmosur nga Kreshnik Omari; më 27.03.2013 në shumën 2.120 lekë, penaltete dhe vetëdeklarim me vonesë, firmosur nga Kreshnik Omari. Shuma totale e paguar nga subjekti i rivlerësimit për legalizimin e objektit, rezulton në vlerën 84.696 lekë (përfshirë komisionet bankare).*

*B/3. Për pasurinë automjet tip “Lancia Thesis”*

17. Komisioni, për këtë pasuri, krijoi bindjen se i përkiste subjektit të rivlerësimit që prej momentit që u ble dhe u soll në Shqipëri dhe se veprimet e kryera prej znj. V. P. ishin të qëllimshme, për të fshehur vlerën reale të këtij automjeti dhe shpenzime të tjera të kryera për të. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë lidhur me pasurinë automjet tip “Lancia Thesis” dhe se ndodhet në kushtet e shkronjave “b” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
18. Subjekti i rivlerësimit kundërshton këto konkluzione të Komisionit, duke pretenduar në ankim se: (i) konkluzioni i Komisionit, që subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë dhe ka mungesë burimesh financiare për blerjen e kësaj pasurie, është i gabuar, pasi subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si blerjen e automjetit ashtu edhe çmimin faktik të tij; (ii) Komisioni nuk arsyeton mospranimin e shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit se znj. V. P. ia shiti automjetin më lirë nga sa e kishte blerë, për shkak të marrëdhënies miqësore të tyre. Komisioni lë pa arsytuar, gjithashtu, përfundimin se znj. V. P. me veprimet e saj ka ndihmuar subjektin për të fshehur vlerën reale të automjetit. Nëse mund të aludohet se ajo e ka bërë këtë për shkak të marrëdhënies së tyre, atëherë përse nuk vlen ky shkak edhe për faktin që ajo ka dashur t'i bëjë një dhuratë; (iii) kjo situatë mund të kualifikohet si mosdeklaram i dhuratës së bërë nga znj. V. P. dhe shkak i mungesës së vëmendjes në përpilimin e saktë të deklaratës periodike vjetore 2013 mund të ketë qenë fakti se nga blerja e automjetit deri në plotësimin e deklaratës periodike vjetore kishte kaluar mbi një vit, si dhe pasojat dhe stresi i divorcit të subjektit të rivlerësimit.
19. Nga analizimi i akteve të dosjes së Komisionit lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues konstaton si vijon.
  - 19.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Autoveturë “Lancia Thesis” e vitit 2008, blerë më 17.01.2013, me burim nga të ardhurat, në vlerën 300.000 lekë.* Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën periodike vjetore 2013, pa deklaruar burimin e të ardhurave për blerjen e saj.
  - 19.2. Në kuadër të hetimit administrativ, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 07.02.2020, vë në dispozicion të Komisionit dosjen e automjeteve në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Automjeti “Lancia” modeli “Thesis”, vit prodhimi 2008, është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit më datë 08.03.2013. Këtë automjet, subjekti i rivlerësimit e ka blerë nga znj. V. P. nëpërmjet kontratë shitblerje automjeti nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.01.2013, në shumën 300.000 lekë, shumë të cilën palët kontraktore deklarojnë se është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Referuar dokumentit “Deklaratë shitje verbale” të shtetasit italian B. R., ky automjet më datë 28.11.2012 i është shitur prej tij znj. V. P., në shumën 9.000 euro, e cila më datë 02.12.2012 ka shlyer dhe detyrimin e zhdoganimit në vlerën 255.991 lekë. Duke përfshirë këtë vlerë në total, automjeti ka kushtuar 1.513.381 lekë dhe i është shitur subjektit të rivlerësimit, një muaj e 20 ditë më pas, në vlerën 300.000 lekë.

**19.3.** Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se me znj. V. P. ka pasur miqësi dhe ka qenë insistimi i saj që subjekti të blinte një automjet të ri, pasi ai që kishte ishte prodhuar para 27 vjetësh. Për këtë arsye, shkuan për turizëm në Romë dhe në të njëjtën kohë të blinin edhe automjetin. Veprimet në Itali u kryen nga znj. V. P. meqë kishte shtetësinë italiane dhe kur erdhën në Shqipëri nënshkruan kontratën e shitjes për vlerën 300.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit shprehet se nuk ka dijeni përse ajo vendosi çmimin 300.000 lekë, ndërkohë që e kishte blerë më shtrenjtë, por ndoshta, sipas tij, për shkak të marrëdhënies së tyre. Subjekti i rivlerësimit shprehet, gjithashtu, se nuk ka bërë deklaram të rremë përderisa ka deklaruar, si blerjen e automjetit, ashtu edhe çmimin faktik të përcaktuar në kontratën e shitblerjes.

**19.4.** Fakti i udhëtimit së bashku për blerjen e automjetit konfirmohet dhe nga të dhënat e sistemit *TIMS*, referuar të cilave subjekti i rivlerësimit dhe znj. V. P. në datën 28.11.2012, kanë dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë nga pika e kalimit kufitar Aeroporti i Rinasit në drejtim të Romës, Itali, me shoqërinë ajrore “{\*\*\*}” dhe janë kthyer në pikën e kalimit kufitar të Portit të Durrësit në datën 02.12.2012, nëpërmjet “Agjencisë {\*\*\*}”, me automjetin objekt shqyrtimi blerë në Itali, me targa {\*\*\*}. Pra, subjekti i rivlerësimit ka qenë së bashku me znj. V. P., kur është blerë automjeti dhe kur janë shlyer detyrimet doganore më datë 02.12.2012. Ashtu siç është deklaruar prej tij gjatë seancës dëgjimore, por edhe në ankim, diferencën e çmimit të blerjes dhe shitjes, subjekti e konsideron dhuratë për shkak të marrëdhënies së tyre miqësore, duke konfirmuar, gjithashtu, se znj. V. P. ka pasur mundësi financiare për të kryer një veprim të tillë.

**19.5.** Trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit në vendim se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë bindës në pretendimet e tij. Ndërsa në Komision subjekti i rivlerësimit shprehet se nuk ishte në dijeni të arsyes se përse znj. V. P. ia kishte shitur automjetin më lirë, në ankim pretendon se maksimumi kjo situatë mund të konsiderohet si mosdeklarim nga ana e tij në deklaratën periodike vjetore 2013 të dhuratës së bërë nga znj. V. P., për shkak të mungesës së vëmendjes në përpilimin e saktë të kësaj deklarate, nisur nga fakti që nga blerja e automjetit deri në plotësimin e saj kishte kaluar mbi një vit, si dhe pasojat dhe stresi prej divorcit. Për trupin gjykues nuk është bindës fakti që automjeti të jetë blerë gjatë udhëtimit të znj. P. me subjektin e rivlerësimit dhe ky i fundit të mos ketë qenë në dijeni të çmimit të blerjes. Nënshkrimi i kontratës së shitjes mes tyre vetëm një muaj e njëzet ditë pas blerjes, në një vlerë rreth pesë herë më të ulët, mbështet konkluzionin e Komisionit se automjeti i përket subjektit të rivlerësimit që në momentin e blerjes së tij. Të gjithë këto elementë bëjnë që subjekti i rivlerësimit të ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer deklaram të rremë në deklaratën e pasurisë *vetting*, lidhur me këtë pasuri. Nga kontrolli i analizës financiare të kryer në Komision, duke konsideruar blerjen e automjetit në datën 28.11.2012 dhe shlyerjen e detyrimeve doganore tërësisht nga subjekti i rivlerësimit dhe jo nga znj. V. P., trupi gjykues konstaton mungesë të burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie në vlerën (-) 1.175.358 lekë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5 shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

*B/4. Për pasurinë velierë, me gjatësi 9 metra*

20. Komisioni në vendim ka arritur në përfundimet se subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme financiare për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, për sa kohë që analiza financiare deri në tetor 2015 rezulton në vlerën negative prej 976.796 lekësh. Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i sinqertë dhe bashkëpunues me Komisionin lidhur me deklaratimet e bëra. Pikërisht në këtë periudhë ka porositur (parapaguar) edhe vendparkimin. Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur për qëllim fshehjen e vlerës reale të investimit dhe përdorimit të kësaj pasurie. Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si dhe nuk është treguar i sinqertë dhe bashkëpunues me Komisionin, duke bërë deklaratime të pasakta lidhur me vendparkimin e velierës, si dhe shpenzime të tjera të kryera për të, rezultuar gjatë hetimit administrativ.
21. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit dhe nëpërmjet ankimit pretendon se: (i) pamundësia financiare e subjektit të rivlerësimit konstatuar nga Komisioni nuk qëndron. Komisioni nuk merr në konsideratë gjendjen *cash* që subjekti ka pasur në banesë deri në prill 2015; (ii) pasaktësinë në deklaratim për velierën, Komisioni e argumenton gabimisht edhe me faktin se nga nëna e subjektit është marrë me qira në datën 12.04.2016 një apartament dhe një vendvarke, në Marinën e Orikutit, Vlorë, duke argumentuar se [...] *subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i sinqertë dhe bashkëpunues me Komisionin, lidhur me deklaratimet e bëra prej tij. Duket se pikërisht në këtë periudhë ka porositur (parapaguar) edhe vendparkimin. Marrja me qira e apartamentit nga nëna ka filluar në vitin 2007 e jo në vitin 2016 dhe nuk ka asnjë lidhje logjike me saktësinë e çmimit apo me blerjen e velierës; (iii) Komisioni arrin në konkluzione të paargumentuara dhe pavarësisht provave të paraqitura nga subjekti, konkludon se ai nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës pa arsyetuar mosmarrjen parasysht të argumenteve të subjekti i rivlerësimit dhe përse mbi to prevalojnë ato të Komisionit.*
22. Nga analizimi i akteve të dosjes së Komisionit lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues konstaton si vijon.
- 22.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi, *velierë 9 metra e blerë në vitin 2015, në vlerën 4.000 euro, me burim nga të ardhurat.* Në deklaratën periodike vjetore 2015, blerjen e kësaj pasurie subjekti i rivlerësimit e deklaroi me burim nga kursimet vjetore.
- 22.2. Drejtoria e Përgjithshme Detare<sup>9</sup> informon se në emër të subjektit të rivlerësimit Kreshnik Omari ky mjet rezulton i regjistruar me këto të dhëna: mjet kënaqësie vetjake (velierë) me gjatësi 9.00 ml, gjerësi 2.8 ml, vit prodhimi 2008, data e blerjes 13.10.2015 dhe datë regjistrimi 23.12.2015, në vlerën 4.000 euro, emërtuar “{\*\*\*}”. Referuar akteve të përcjella, varka rezulton e përfituar me “Deklaratë verbale për shitje varke” më datë 13.10.2015, nënshkruar nga shtetasi italian M. P. në cilësinë e pronarit, i cili deklaroi se i ka shitur z. Kreshnik Omari varkën e vetëndërtuar emërtuar “{\*\*\*}”, tip mjet lundruar me motor ndihmës, në çmimin e paguar prej 4.000 eurosh.
- 22.3. Në përgjigjet e pyetësorit të datës 18.03.2021 të Komisionit, lidhur me shpenzimet e kryera për velierën, subjekti i rivlerësimit është shprehur se e ka lënë në përdorim të kushëritit të tij, z. L. B., në Vlorë, qëkur e ka blerë dhe nuk ka shpenzime për të deklaruar. Ndërkohë nga

<sup>9</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 07.06.2017.

analizimi i lëvizjeve të llogarisë *tërheqje me Master Card* (nr. {\*\*\*}), në monedhën euro, përcjellë nga “Raiffeisen Bank” ShA<sup>10</sup>, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë disa blerje *online* në faqen *NAUTICAILLI*<sup>11</sup>, nëpërmjet të cilës tregtohen aksesore dhe pjesë këmbimi për mjete lundruese, në datat 30.06.2016 dhe 29.07.2016, në vlerën totale prej 1.436 eurosh. Për këtë konstatim të Komisionit, subjekti i rivlerësimit në ankim shprehet se shpenzimet prej 1.436 eurosh të kryera me kartën e kreditit ishin për disa pjesë këmbimi, të cilat sikurse për pjesët e këmbimit të automatizuar, nëse nuk kalojnë shumën 300.000 lekë nuk klasifikohen në shpenzime të detyrueshme për t’u deklaruar. Trupi gjykues vlerëson se qëndrimi i subjektit të rivlerësimit nuk ka qenë korrekt, pasi Komisioni gjatë hetimit administrativ nuk i është referuar shpenzimeve të deklarueshme në kuptim të nenit 4, shkronja “h” e ligjit nr. 9049/2003, por verifikimit të vërtetësisë së deklarimeve të subjektit në raport me të dhënat e rezultuara nga hetimi për shpenzimet e kryera për mjetin lundrues.

**22.4.** Gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se me shitësin e velierës, z. M. P., kishte miqësi të vjetër që nga viti 1997 kur punonte në Napoli, Itali. Shitësi i velierës është zdukthëtar profesionist dhe e kishte ndërtuar vetë velierën, me të cilën në vitin 2009 kishte ardhur në Shqipëri. Mbas disa vitesh i bën me dije subjektit të rivlerësimit se do të ndërtonte një velierë tjetër më të madhe dhe nuk mund të mbante dy, duke i propozuar atij të blinte velierën me një çmim 4.000 euro. Sipas subjektit të rivlerësimit, referenca që është marrë për të paguar doganën mund të ketë qenë pak më e lartë, si për varkat e ndërtuara nga kantierët, ndërkohë që ky është një ndërtim artizanal, një prodhim amator dhe jo prodhim kantieri dhe nuk mund të barazohet me vlerën e një varke të ndërtuar në kantier. Nuk përjashtohet mundësia, sipas subjektit të rivlerësimit, që për shkak të miqësisë t’i jetë dhënë një çmim pak më i ulët sesa do t’i ishte shitur dikujt tjetër. Çmimi prej 4.000 eurosh ishte çmimi real i paguar nga subjekti dhe nuk mund të deklaronte çmim tjetër.

**22.5.** Për sa i përket mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, Kolegjit i rezulton se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 262.348 lekë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë gjendjen *cash* në banesë deri në vitin 2015, ndërkohë që nuk e ka pretenduar si burim as në deklaratën periodike vjetore 2015 dhe as në deklaratën e pasurisë *vetting*. Për më tepër, gjendja *cash* në shumën 135.000 euro rezulton të jetë përdorur për krijimin e depozitës bankare më 24.04.2015, ndërsa veliera është blerë gjashtë muaj më pas, më 13.10.2015. Lidhja e kësaj pasurie me apartamentin dhe vend akostimin e varkës në Orikum, Vlorë, kontraktuar nga nëna e subjektit të rivlerësimit 6 (gjashtë) muaj pas blerjes së velierës, do të trajtohet në paragrafin 33.6 të këtij vendimi.

*B/5. Për pasurinë depozitë bankare, në shumën 135.019 euro*

- 23.** Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në pamundësi financiare me burime të ligjshme për krijimin e depozitës bankare çelur në datën 24.04.2015 në

<sup>10</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 04.02.2020, e “Raiffeisen Bank” ShA.

<sup>11</sup> <https://www.nauticailliano.it/>



“Raiffeisen Bank” ShA dhe ndodhet në kushtet e shkronjës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

24. Referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, shuma prej 135.019 eurosh përbëhej nga: (i) shuma 97.000 euro deklaruar *cash* në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie 2003, me burim krijimi nga puna si emigrant, puna si avokat dhe si gjyqtar; si dhe (ii) diferenca 38.000 euro e krijuar në vitet në vazhdim me të ardhura nga pagat e subjektit dhe ish-bashkëshortes.
25. Lidhur me gjendjen *cash* 97.000 euro, subjekti i rivlerësimit në ankim ka pretenduar se: (i) konkluzioni i Komisionit, lidhur me pamundësinë financiare me burime të ligjshme për krijimin e depozitës, është i gabuar; (ii) nga puna në emigracion në Itali dhe provat e vëna në dispozicion, Komisioni ka njohur vetëm shumën 76.064.077 lireta italiane kundrejt shumës 167.862.348 lireta italiane përlllogaritur prej tij. Komisioni ka një gabim në përlllogaritje, pasi shuma në zarfet e pagave mujore rezulton 77.006.865 lireta italiane, por që kjo shumë në fakt nuk përfaqëson të ardhurat e plota të përfituara, por vetëm 60-70% të pagës së përfituar efektivisht e në mënyrë të padrejtë nuk është marrë në konsideratë; (ii) Komisioni nuk ka llogaritur pagesat e shënuara në fletët e verdha që shoqëronin zarfet e pagave mujore te kompania e transportit dhe dërgesave “{\*\*\*}” dhe që përfaqësonin pagesat për orët jashtë orarit, transfertat dhe për punën e kryer të shtunë dhe të diel, që arrinin vlerën 24.892.000 lireta italiane; (iii) Komisioni nuk ka marrë parasysh faktin që për të paktën tre muaj, nëpërmjet disqeve të tahogرافit që regjistrojnë shpejtësinë e kamionit, orët e punës, si dhe kilometrat e përshkruara, mund të provohet punësimi në kompaninë “{\*\*\*}”, Napoli, Itali. Nga Komisioni nuk janë marrë parasysh një sërë faktesh dhe nuk janë përmendur as në vendim, ndërkohë që Komisioni duhej të kundërshtonte pretendimet e subjektit, për sa sipërparaqitur në shpjegime mbi rezultatet e hetimit dhe në seancë dëgjimore.
26. Nga analizimi i akteve të dosjes së Komisionit lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues konstaton, si vijon.

26.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi depozitën në vlerën 135.019 euro, në “Raiffeisen Bank” ShA, e çelur më 24.04.2015, mbas vendosjes në bankë të gjendjes *cash* të krijuar nga puna për 5 vjet si emigrant në Itali 1991-1995, si avokat 1995-1997, si gjyqtar 1997 e në vijim, nga të ardhurat e ish-bashkëshortes si avokate nga 2003-2011 dhe notere nga 2011-2012 (divorcuar në korrik 2012), si dhe nga trashëgimia mbas vdekjes së babait. Nga këto, 97.000 euro janë deklaruar *cash* që në deklarimin e parë në vitin 2003 dhe diferenca prej 38.000 euro në vitet në vazhdim.

26.2. Depozitimi në sistemin bankar i gjendjes *cash* u krye me udhëzimin e dhënë prej Inspektorit të ILDKPKI-së nëpërmjet *e-mail*-it të datës 15.04.2015, në kuadër të kontrollit të plotë të kryer ndaj subjektit deklarues Kreshnik Omari. Pas depozitimit, më datë 24.04.2015, në “Raiffeisen Bank” ShA, të shumave 95.000 euro dhe 5.600.000 lekë, gjithsej 135.000 euro, subjekti i rivlerësimit i ka përcjellë Inspektorit të ILDKPKI-së dokumentin “*depozitim nr. llogari personale*”.

26.3. Lidhur me shumën 97.000 euro të deklaruar gjendje *cash* në deklaratën e personi që mbart detyrimin për deklarim pasurie 2003, gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i

rivlerësimit ka sqaruar se për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar nuk është në gjendje të japë të dhëna të sakta sa kanë qenë të ardhurat nga puna në emigracion, nga avokatia apo puna si gjyqtar. Megjithatë, ai shprehet se rreth 80-90% kanë qenë rezultat i punës në emigracion dhe pjesa tjetër nga puna si avokat dhe gjyqtar.

**26.4.** Sipas subjektit të rivlerësimit, të ardhurat nga punësimi në emigracion kanë qenë të konsiderueshme, për shkak të punës së tij si shofer me kamion në rrugë të gjata, kategoria e tretë super, prej nga varej dhe kualifikimi i pagesës. Gjatë qëndrimit në Itali, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka përfituar në total rreth 167.762.348 lireta italiane të ardhura nga punësimi në kompanitë: (i) “{\*\*\*}” snc si magazinier dhe shpërndarës ushqimesh, të ardhurat e përfituara 3.800.000 lireta italiane; (ii) për rreth 25 ditë ka punuar pa kontratë pune në një zdrukthëtari dhe u pagua rreth 1.300.000 lireta italiane; (iii) “{\*\*\*}”, të ardhurat e përfituara 5.200.000 lireta italiane; (iv) “{\*\*\*}”, të ardhurat e përfituara 24.000.000 lireta italiane; (v) “{\*\*\*}” snc, të ardhurat e përfituara 90.562.348 lireta italiane; (vi) “{\*\*\*}”, të ardhura e përfituara 43.000.000 lireta italiane. Shuma që figuronte në zarfet e pagave mujore në kompaninë “{\*\*\*}” snc, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk i përgjigjej realitetit, por përfaqësonte rreth 60-70% të pagesës mujore, pasi në të nuk përfshiheshin orët jashtë orarit, transfertat dhe puna gjatë ditës së shtunë, të cilat paguheshin jashtë zarfit të pagës mujore, në fletë të verdha. Në rastet kur në zarf nuk është ruajtur shënimi i fletës së verdhë, ai duhet të llogaritet për çdo ditë pune nga 40.000 deri në 60.000 lireta italiane në ditë, duke marrë për referencë tarifën e llogaritur në fletën e verdhë të muajit më të afërt.

**26.5.** Për të provuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për krijimin e gjendjes *cash* prej 97.000 eurosh, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën nëntor 1997-2003, në një variant duke mos i përfshirë të ardhurat nga emigracioni dhe në variantin tjetër, në analizë me rezervë ka konsideruar të ardhura nga emigracioni në masën 40.000 euro konvertuar në 7.996.722 lekë. Rezultatet e analizës financiare treguan për secilin variant respektivisht, balancat negative (-) 11.893.478 lekë dhe (-) 6.547.478 lekë. Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni është i paqartë për rezultatin financiar të kësaj periudhe, duke konkluduar në tre diferenca negative, konkretisht: (-) 11.893.478 lekë, (-) 6.547.478 lekë në analizën me rezervë, si dhe në diferencën negative përfundimtare (-) 14.161.253 lekë, e cila së bashku me mungesën e burimeve financiare të konstatuar nga Komisioni për periudhën janar 2004-dhjetor 2016 në vlerën (-) 8.214.248 lekë, arrin në mungesën totale (-) 22.375.501 lekë, si pasqyruar në paragrafin 24.5 të vendimit objekt shqyrtimi. Ajo që konstatohet në analizën financiare me rezervë është që Komisioni, për periudhën e emigracionit 1991-1995, përlllogarit vetëm të ardhurat e evidentuara në dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit, pa përfshirë shpenzimet e jetesës për periudhën nën analizë.

**26.6.** Lidhur me të ardhurat nga emigracioni në Itali, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision këto dokumente: (i) kopje të librezës së punës për shtetas të huaj ekstrakomunitarë, nr. {\*\*\*} regj.; (ii) deklaratë<sup>12</sup> lëshuar nga kompania autotransport dhe dërgesa “{\*\*\*}” snc për subjektin e rivlerësimit për t’u përdorur sipas ligjit së bashku me lejen e punësimit lëshuar

<sup>12</sup> Sipas kësaj deklaratë lëshuar më 27.05.1993, kompania “{\*\*\*}” snc deklaroi se z. Kreshnik Omari është aktualisht punonjës i kompanisë në cilësinë e shoferit në kategorinë e tretë niveli superior, i regjistruar në librin e matrikullimit numër {\*\*\*}, sipas lejes nr. {\*\*\*}, lëshuar në datën 21.09.1992.

nga Zyra e Punës më datë 21.09.1992, si dhe zarfet e pagës mujore të kësaj kompanie për periudhën shtator 1992-korrik 1994; (iii) dokument page lëshuar nga kompania “{\*\*\*}” snc për periudhën korrik-gusht 1991, si punonjës me kohë të pjesshme, si dhe pagesa pas përfundimit të marrëdhënies së punës; (iv) dokument page nga kompania “{\*\*\*}” për periudhën shkurt-gusht 1992; (v) disqe të tahografit që regjistrojnë orët e punës dhe shpejtësinë e lëvizjes së kamionit për muajt qershor 1994 dhe qershor-korrik 1997.

**26.7.** Nga analizimi i akteve të administruara në dosje që përmbajnë të dhëna për pagesat e përfituara nga punësimi, trupit gjykues i rezulton se për periudhën korrik 1991-korrik 1994 të ardhurat kanë qenë në vlerën totale 77.006.861 lireta italiane<sup>13</sup> konvertuar në 39.770 euro. Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nga puna në emigracion ka përfituar në total shumën 167.862.348 lireta italiane konvertuar në vitin 1994 në 107.115 USD dhe në vitin 2000, në vlerën 95.908 euro, mbetet i paprovuar. Mbeten, gjithashtu, në nivel deklarativ edhe pretendimet e subjektit se shumatat në zarfet e pagave mujore nuk përfaqësojnë shumën e saktë që ai ka përfituar, por vetëm 60-70% të pagës në kompaninë “{\*\*\*}” snc dhe në masën 30- 40 % të të ardhurave në kompaninë “{\*\*\*}”. Trupi gjykues vlerëson se me të drejtë Komisioni nuk ka përfshirë në llogaritje pagesat e shënuara në fletë të verdha që shoqëronin zarfet e pagës mujore nga kompania “{\*\*\*}” snc, të cilat, sipas subjektit, përfaqësonin pagesat për punën e kryer të shtunë dhe të diel, si dhe orët jashtë orarit, në vlerën 24.892.000 lireta italiane. Fletët e verdha nuk përbëjnë dokument ligjor dhe nuk kanë asnjë vlerë provuese në këtë proces. Përpos sa më sipër, nga analizimi i zarfeve të pagave mujore të kësaj kompanie, në shumën totale të paguar, përfshihen dhe zëra të tillë si pagesa jashtë orarëve apo pagesa për ditët e pushimit/festave, si dhe rezulton e dokumentuar me zarf paga e 13-të apo 14-të.

**26.8.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka marrë parasysh faktin që për të paktën tre muaj nëpërmjet disqeve të tahografit që regjistrojnë shpejtësinë e kamionit, orët e punës, si dhe kilometrat e përshkruara, provohet punësimi i tij në firmën “{\*\*\*}” Napoli, Itali, trupi gjykues vlerëson se në kuadër të këtij procesi konsiderohen të ardhura të ligjshme ato për të cilat minimalisht provohet ekzistenca me dokumentacion justifikues ligjor, si dhe plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës. Në këto kushte, disqet e tahografit mund të japin të dhëna për punësimin e subjektit të rivlerësimit për tre muaj në vitin 1997, por nuk përmbajnë asnjë informacion mbi të ardhurat konkrete të përfituara nga ky punësim e, aq më pak, shlyerje detyrimesh për to.

**26.9.** Për të ardhurat nga puna si avokat, përveç dokumentacionit të licencimit dhe regjistrimit<sup>14</sup> si i tillë, si dhe derdhjes së kontributeve shoqërore për 3 (tre) muaj të periudhës tetor-dhjetor 1996, subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokument provues mbi të ardhurat nga ushtrimi i këtij aktiviteti. Ndërsa të ardhurat nga puna si gjyqtar për periudhën 1997-2003 janë përlllogaritur nga Komisioni, sipas dokumentacionit justifikues të administruar.

---

<sup>13</sup> Vlera totale prej 77.006.861 lireta italiane, përbëhet nga 66.777.697 lireta italiane të ardhura nga punësimi në kompaninë “{\*\*\*}” snc, 8.468.787 lireta italiane të ardhura nga puna në kompaninë “{\*\*\*}”, si dhe 1.760.377 lireta italiane nga shoqëria “{\*\*\*}”.

<sup>14</sup> Leje nr. {\*\*\*}, datë 27.08.1992, “Për ushtrimin e profesionit të avokatit”, lëshuar për z. Kreshnik Omari nga Këshilli Mbikëqyrës i Avokatisë; vendim nr. {\*\*\*}, datë 25.08.1994, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, për regjistrimin si person fizik të z. Kreshnik Omari për të ushtruar profesionin e avokatit; certifikatë për regjistrimin si biznes i vogël i personit fizik, në organin tatimor nr. {\*\*\*}, për vitin 1997.

**26.10.** Në kuadër të verifikimit të mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për të krijuar kursime *cash* në shumën 97.000 euro deri në fund të vitit 2003, Kolegji, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrollon analizën financiare të Komisionit, rezultatet e së cilës treguan se subjekti i rivlerësimit ndodhet në pamjaftueshmëri financiare nga burime të ligjshme në vlerën (-) 14.212.321 lekë, për të justifikuar shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara deri më 31.12.2003, duke mos konsideruar në analizë të ardhura nga emigracioni, në kushtet kur nuk provon ekzistencën apo transferimin e shumave të pretenduara nga Italia në Shqipëri. Për më tepër, mbeten të paqarta arsyet përse subjekti i rivlerësimit duhet të mbante gjendje *cash* në banesë shuma të konsiderueshme, ndërkohë që prej vitit 2003 ai ka përdorur llogaritë bankare për ruajtjen e kursimeve të tij, konkretisht të shumës 1.000.000 lekë në “ProCredit Bank” ShA (ish-Fepad Bank ShA) dhe shumës 3.500 euro në ish-Bankën e Kursimeve. Megjithatë, edhe nëse në analizë do të konsideroheshin të ardhurat nga punësimi në emigracion në vlerën 77.006.861 lireta italiane ose 4.520.303 lekë, sipas të dhënave të dokumentacionit të administruar, duke zbritur shpenzimet e jetesës për këtë periudhë, përllogaritur bazuar në të dhënat e publikuara nga Instituti i Statistikave të Italisë, atëherë diferenca negative do të reduktohej në (-) 12.153.973 lekë.

27. Lidhur me gjendjen *cash* 38.000 euro, të pretenduar të krijuar gjatë periudhës 01.01.2004-24.04.2015, Komisionit, duke marrë në konsideratë si shpenzim edhe shumën 15.000 euro, që subjekti i rivlerësimit i ka dhënë ish-bashkëshortes në kuadër të zgjidhjes së martesës, të padeklaruar prej tij, por të konstatuar gjatë hetimit administrativ, i rezultoi që subjekti i rivlerësimit ka pasur pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 2.215.859 lekë për të krijuar gjendjen *cash* në shumën 38.000 euro.

28. Subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë konkluzion të Komisionit duke ngritur në ankim, pretendimet se: (i) lidhur me të ardhurat e ish-bashkëshortes, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë deklaratat në deklaratën periodike vjetore 2007. Deklarata noteriale e ish-bashkëshortes, sipas Komisionit, jep të dhëna vetëm për të ardhurat dhe jo për fitimin e realizuar dhe pavarësisht se nga vërtetimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, rezulton se ish-bashkëshortja për vitin 2007 ka deklaruar nivelin e qarkullimit vjetor/xhiro 0-2.000.000 lekë dhe ka likuiduar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore në shumën 29.050 lekë, Komisioni pretendon të kundërtën; (ii) nga njëra anë Komisioni njeh si të ligjshme depozitat e babait të subjektit të rivlerësimit në shumën 1.000.000 lekë dhe 500.000 lekë, nga ana tjetër nuk njeh si kursim *cash* shumën 700.000 lekë që subjekti i rivlerësimit ka trashëguar prej tij.

29. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortes, nga analizimi i akteve të dosjes së Komisionit, trupi gjykues konstaton se:

**29.1.** Në deklaratat periodike vjetore, rezultojnë të jenë deklaruar të ardhura nga punësimi i bashkëshortes si vijon: në deklaratë e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie 2003, shuma 196.000 lekë, si avokate; nuk janë deklaruar të ardhura për vitet 2004, 2005 dhe 2006 në deklaratat periodike përkatëse; në vitin 2007, të ardhura nga puna e bashkëshortes si avokate, 1.400.000 lekë; në vitin 2008, të ardhura nga puna e bashkëshortes si avokate 1.950.000 lekë; në vitin 2009, të ardhura nga puna e bashkëshortes si avokate 1.950.000 lekë; në vitin 2010,

të ardhura nga puna e bashkëshortes, avokate 935.000 lekë; në vitin 2011, të ardhura nga paga e bashkëshortes (avokate dhe më pas notere) 1.331.560 lekë.

**29.2.** Gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, për të provuar këto të ardhura, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur: (i) ekstrakt historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e personit fizik “{\*\*\*}”, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më datë 20.09.2007, me fushë veprimtarie “avokati” dhe më pas më datë 29.06.2011, ndryshon objektin e veprimtarisë në “notere”; (ii) shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 21.08.2020, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, e cila jep të dhëna mbi të ardhurat e raportuara nga personi fizik “{\*\*\*}”, me NIPT {\*\*\*}, për periudhën 2008-2012<sup>15</sup>; (iii) shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 16.03.2021<sup>16</sup>, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, sipas së cilës subjekti “{\*\*\*}” person fizik është regjistruar në sistem për herë të parë në vitin 2007; (iv) deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 29.06.2021, të znj. Xh. O., e cila deklaron: për vitin 2007, xhiro vjetore 1.400.000 lekë dhe fitim 1.200.000 lekë; për vitin 2008, xhiro vjetore 1.950.000 lekë dhe fitimi 1.700.000 lekë; për vitin 2009 xhiro vjetore 1.950.000 lekë dhe fitim 1.600.000 lekë; për vitin 2010, xhiro vjetore 935.000 lekë dhe fitim 600.000 lekë; për vitin 2011, xhiro vjetore 1.616.717 lekë dhe fitim 1.331.560 lekë.

**29.3.** Pavarësisht pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se ish-bashkëshortja ka punuar si avokate nga viti 2003 e pajisur me licencën e avokatisë, por e pa regjistruar në organet tatimore deri në vitin 2007, vit në të cilin pretendon të ketë realizuar të ardhura në shumën 1.400.000 lekë, sikurse deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2007, trupi gjykues vlerëson se në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, konsiderohen të ardhura të ligjshme ato për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, kërkesë e parashikuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, dispozitë e zbatuar drejt nga Komisioni. Në analizën financiare të kryer prej tij, të ardhurat e bashkëshortes janë konsideruar sipas të dhënave përcjellë Komisionit me shkresat nr. {\*\*\*} prot., datë 02.08.2017 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 08.09.2017, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë drejtuar ILDKPKI-së. Referuar këtyre shkresave, znj. Xh. O., administratore e subjektit “{\*\*\*}” person fizik, nga data e regjistrimit të subjektit në QKB më 20.09.2007, me status aktiv nga data 01.10.2007, ka dorëzuar deklaratat e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël për periudhën 2008-2013, si vijon: (i) viti 2008, xhiro vjetore 1.470.000 lekë, humbje 329.142 lekë; (ii) viti 2009, xhiro vjetore 1.950.000 lekë, fitim 600.000 lekë; (iii) viti 2010, xhiro vjetore 930.000 lekë, fitimi 600.000 lekë; (iv) viti 2011, xhiro vjetore 1.616.717 lekë, fitim 1.331.558 lekë; (v) viti 2012, xhiro vjetore 6.053.442 lekë, fitim 2.796.033 lekë, etj. Në kushtet kur sipas të dhënave të QKB-së, personi fizik “{\*\*\*}” rezulton e regjistruar më 20.09.2007 dhe sipas Drejtorisë Rajonale e Tatimeve Tiranë figuron me status aktiv nga data

<sup>15</sup> Sipas shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 21.08.2020, të ardhurat rezultojnë: për vitin 2008 në masën 1.470.000 lekë; për vitin 2009, në masën 1.950.000 lekë; për vitin 2010 në masën 930.000 lekë; për vitin 2011 në masën 1.616.717 lekë; për vitin 2012 në masën 6.053.442 lekë.

<sup>16</sup> Sipas shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 16.03.2021: për vitin 2007, subjekti ka deklaruar nivelin e qarkullimit vjetor/xhiro 0-2 milionë lekë dhe ka likuiduar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore në shumën prej 29.050 lekë; për vitin 2008 ka deklaruar nivelin e qarkullimit vjetor/xhiro 2-3 milionë lekë dhe ka likuiduar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore në shumën prej 74.600 lekë; për vitin 2009, ka deklaruar nivelin e qarkullimit vjetor/xhiro 2-3 milionë lekë dhe ka likuiduar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore në shumën prej 80.800 lekë; për vitin 2010, ka deklaruar nivelin e qarkullimit vjetor/xhiro 2-3 milionë lekë dhe ka likuiduar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore në shumën prej 78.520 lekë; për vitin 2011 ka deklaruar nivelin e qarkullimit vjetor/xhiro 0-2 milionë lekë dhe ka likuiduar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore në shumën prej 39.545 lekë.

01.10.2007, ndërkohë që për këtë vit nuk ka deklaruar xhiro vjetore, të ardhurat në shumën 1.400.000 lekë të deklaruara në deklaratën periodike vjetore 2007, me të drejtë nuk janë përfshirë në analizën financiare të Komisionit, pasi nuk përmbushin kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

**29.4.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni, duke pasur parasysh mundësinë evidente që ka pasur babai i subjektit për kursim, ka njohur si të ligjshme depozitat bankare të tij në shumat 1.000.000 lekë dhe 500.000 lekë, ndërkohë që nuk i njeh si kursim shumën *cash* 700.000 lekë të trashëguar prej tij dhe duke mos marrë në konsideratë deklaratimet në deklaratën periodike vjetore 2011, trupi gjykues konstaton si vijon.

**29.4.1.** Në deklaratën periodike vjetore 2011, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka përfituar me trashëgimi nga babai i tij F. O., 50 % të pasurive si më poshtë: (1) 1/3 e apartamentit të përbashkët, i deklaruar më parë; (2) dy llogari bankare në “ProCredit Bank” ShA në shumat 1.000.000 lekë dhe 500.000 lekë të krijuara ndër vite nga babai; (3) llogari bankare në “Raiffeisen Bank” ShA, në shumën 250.000 lekë të krijuar ndër vite nga babai; (4) gjendje *cash* në shumën 1.400.000 lekë të krijuara ndër vite nga babai. Me deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka depozituar vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.12.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësin, z. F. O., duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjor të radhës së parë bashkëshorten E. O. dhe të birin Kreshnik Omari, me ½ pjesë secili të pasurisë së luajtshme e të paluajtshme, si dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo trashëgimi.

**29.4.2.** Trupi gjykues, nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, vëren se pavarësisht që Komisionit i ka rezultuar e paprovuar me dokumentacion mundësia financiare e babait të subjektit të rivlerësimit për krijimin e depozitave në “ProCredit Bank” ShA, më 03.06.2009 në vlerën 500.000 lekë dhe më 12.02.2011 në vlerën 1.000.000 lekë, nisur nga fakti që këto llogari bankare në fund të vitit 2016 rezultonin ende në emër të babait, si dhe nuk kishin shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie, për të mos rënduar situatën financiare të subjektit të rivlerësimit edhe për këto pasuri të trashëguara, Komisioni ka pranuar shpjegimet e tij. Me fjalë të tjera, Komisioni nuk është shprehur për ligjshmërinë e këtyre depozitave bankare siç pretendon subjekti i rivlerësimit në ankim, por me konsideratë rrethanat e përmendura mësipër nuk ka konsideruar efektin e tyre në vendimmarrjen ndaj subjektit të rivlerësimit Kreshnik Omari.

**29.4.3.** Në kushtet kur gjatë hetimit administrativ Komisioni u vu në dijeni për transaksione bankare dhe pasuri të paluajtshme në emër të prindërve të subjektit të rivlerësimit, të cilat për shkak të periudhës dhe rrethanave në të cilat janë kryer iu nënshtruan kontrollit të Komisionit, pasi u dyshua të ishin pasuri të fshehura të tij, ka kërkuar nga subjekti i rivlerësimit të provojë të ardhurat e prindërve. Sipas Komisionit në vendim, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor të ardhurat e prindërve për krijimin e shumës 160.000 euro investuar për blerje njësie (dyqan) në vitin 2010 dhe të shumës 2.800.000 lekë investuar për blerje të dy vendparkimeve në vitin 2011. Për rrjedhojë, edhe shuma 700.000 lekë e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi për depozitën bankare 135.019 euro, me të drejtë nuk është përfshirë në analizën financiare të Komisionit.

**29.5.** Mbështetur në arsyetimin më sipër, trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrollon analizën financiare të Komisionit për periudhën 01.01.2004-24.04.2015 dhe arriti në

konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 4.167.822 lekë për të justifikuar shpenzimet e kryera, pasuritë e krijuara dhe kursimet e realizuara, përfshirë kursimin në shumën 38.000 euro. Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni është i paqartë për rezultatin financiar të kësaj periudhe, duke konkluduar në dy diferenca negative: (-) 2.215.859 lekë dhe me të njëjtin arsyetim si në paragrafin 26.5. të këtij vendimi, në rezultatin final konkludon në (-) 8.214.248 lekë [(-) 22.375.501 lekë – (-) 14.161.253 lekë]. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, si për krijimin e kursimit të shumës *cash* 97.000 euro deri në dhjetor 2003, ashtu edhe për kursimin e shumës 38.000 euro deri më 24.04.2015, trupi gjykues vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për krijimin e depozitës në vlerën 135.019 euro në “Raiffeisen Bank” ShA në prill 2015, me burim këto dy shuma.

*Lidhur me transaksionet e kryera nga prindërit e subjektit të rivlerësimit*

30. Në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni vihet në dijeni nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave<sup>17</sup> për disa transaksione të kryera nga nëna dhe babai i subjektit të rivlerësimit, raportuar pranë këtij institucioni nga noterët, konkretisht për: (i) kontratë qiraje të një apartamenti, vendvarke, si dhe dhënie në përdorim të shërbimeve portuale në Orikum, Vlorë, në vlerën 99.600 euro; (ii) kontratë porosie për apartamentin ndodhur në “{\*\*\*}”, Tiranë, në vlerën 80.000 euro, pasuri këto të kontraktuara nga nëna e subjektit të rivlerësimit; si dhe (iii) kontratë premtim shitje e dy vendparkimeve në Tiranë, në vlerën 2.800.000 lekë, nga babai i subjektit të rivlerësimit.

*Për pasurinë, apartament me sipërfaqe 52,7 m<sup>2</sup> dhe vendvarke në Orikum, Vlorë*

31. Komisioni, për këtë pasuri, krijon bindjen se është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit dhe se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pikës 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
32. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, duke ngritur në ankim pretendimet se: (i) Komisioni pa u mbështetur në asnjë provë dhe pa arsyetuar hedh poshtë analizën financiare të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit dhe arrin në konkluzionin se kjo është pasuri e fshehur e tij; (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka detyrimin të provojë burimin e krijimit të pasurisë së prindërve të tij në përgjithësi dhe në rastin konkret të nënës, në kushtet e mungesës së marrëdhënies së interesit mes tyre. Analiza financiare e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit provon se nëna e tij ka qenë në gjendje të përballonte shpenzimin; (iii) Komisioni nuk merr parasysh vërtetimin e lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK mbi pagesat e kryera nga nëna e subjektit të rivlerësimit, me argumentin se ky dokument nuk u paraqit nga noterja gjatë hetimit administrativ në Komision, ndërkohë që dokumenti i paraqitur është nxjerrë nga arkiva e saj; (iv) Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës pa bërë asnjë kundërgargumentim me prova se përse nuk merren parasysh argumentet e dhëna prej tij dhe përse ato të Komisionit prevalojnë.

<sup>17</sup> Njëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 31.01.2020.

33. Nga analizimi i akteve të dosjes së Komisionit, lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues konstaton:
- 33.1.** Mes nënës së subjektit të rivlerësimit, znj. E. O., në cilësinë e qiramarrëses dhe qiradhënësit, shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, nënshkruhet *kontratë qiraje apartamenti e vendi varke dhe përdorim i shërbimeve portuale mbi dhjetë vjet nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 12.04.2016*, me objekt, një apartament të mobiluar me sipërfaqe 52,7 m<sup>2</sup>, pasuria nr. {\*\*\*}, zona kadastrale {\*\*\*}, ndodhur në Orikum, Vlorë, një vendbarke për akostimin e një barke me gjatësi maksimale 12 metra, gjerësi 3.80 metra, numërtuar nr. {\*\*\*} dhe dhënien në përdorim të shërbimeve portuale, për të cilat znj. E. O. ka derdhur në favor të shoqërisë vlerën 99.600 euro, që përfshin pagesën e plotë për të gjithë periudhën nga data e nënshkrimit të kontratës deri në datën 22.03.2095.
- 33.2.** Pavarësisht pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se transaksioni, kontrata dhe sendi i paluajtshëm nuk kanë lidhje me të, nuk bën pjesë në pasuritë e deklaruara apo të poseduara prej tij dhe, rrjedhimisht, nuk disponon dokumente, në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni duke pasur parasysh moshën e nënës së subjektit të rivlerësimit (82 vjeç në momentin e lidhjes së kontratës) dhe zotërimin e një mjeti velierë nga subjekti i rivlerësimit blerë në tetor 2015, duket se kjo kontratë është lidhur për marrjen me qira të një apartamenti dhe të një vendi akostimi varke, si dhe përdorimin e shërbimeve portuale nga subjekti i rivlerësimit për velierën e tij. Në këto kushte, në bazë të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kalon subjektit të rivlerësimit barrën e provës për këto konstatime: (a) kontrata e qirasë e lidhur nga nëna e subjektit të rivlerësimit është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit; (b) subjekti i rivlerësimit nuk ka bashkëpunuar me Komisionin duke mos dhënë shpjegime, duke mos depozituar dokumentacion provues ligjor për burimin e ligjshëm të të ardhurave për pagesën 99.600 euro, si dhe shkakun për marrjen me qira të kësaj pasurie nga nëna e tij; (c) subjekti i rivlerësimit duhet të provojë qëllimin e lidhjes së kësaj kontrate nga nëna e tij, burimin e të ardhurave (kryesisht të shumës 80.000 euro), si dhe mënyrën e pagimit të saj nëse kjo pasuri nuk është “pasuri e fshehur” e vetë subjektit të rivlerësimit apo të provojë të kundërtën e këtij rezultati hetimi.
- 33.3.** Për të provuar të kundërtën e barrës së provës me shpjegimet e dhëna, subjekti i rivlerësimit sqaroi se apartamenti dhe vendi i varkës nuk kanë lidhje me blerjen prej tij të velierës në tetor 2015. Ai është sqaruar nga nëna e tij se ky apartament është marrë me qira dhe është poseduar prej saj që në verën e vitit 2007 dhe jo në vitin 2016, vit në të cilin është bërë kontrata përfundimtare e marrjes me qira, pasi është paguar kësti i fundit. Pagesat e tjera ishin bërë prej saj që në vitin 2007 dhe 2008, siç rezulton edhe nga vërtetimi i pagesave lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, bashkëlidhur kontratës së qirasë. Pagesat, sipas subjektit të rivlerësimit, janë përballuar nga nëna me kursimet e saj, e cila, gjithashtu, i ka sqaruar se për marrjen me qira është përdorur edhe shuma prej 90.000 eurosh që asaj dhe babait të subjektit ua kishte dhënë z. V. I., mik i tyre, aktualisht ndërtues, me të cilin kishin bërë një marrëveshje në vitin 2007, që nëse do të privatizohej trualli 460 m<sup>2</sup> të ish-Parku i Delegacioneve, njohur babait me vendim të Komisionit të Kthimit të Pronave si trashëgimtar i z. B. O., do t’i jepej atij e drejta e investimit mbi këtë truall. Me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit paraqet kontratën e qirasë së apartamentit dhe vendvarke, tërhequr posaçërisht prej



noteres nga nëna e tij, bashkëlidhur së cilës gjendet “Vërtetimi i pagesave”<sup>18</sup> datë 14.12.2015 lëshuar nga administratori i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Sipas këtij vërtetimi, klientja E. O. ka derdhur për llogari të shoqërisë për qiranë e apartamentit 22, kati i dytë dhe për përdorimin e një vendi varke: (1) më datë 23.07.2007 shumën 74.700 euro; (2) më datë 21.07.2008 shumën 8.300 euro; dhe (3) më datë 14.12.2015 shumën 16.600 euro, duke konfirmuar kështu likuidimin e shumave të mësipërme e duke mos pasur më detyrim ndaj shoqërisë, përveç detyrimeve vjetore në kushtet e bashkëpronësisë.

**33.4.** Trupi gjykues çmon të drejtë konstatimin dhe vlerësimin e Komisionit në vendim se vërtetimi i pagesës, nënshkruar vetëm nga administratori i shoqërisë dhe jo nga të dyja palët kontraktore, nuk ishte përcjellë nga noterja me praktikën e dërguar prej saj në Komision gjatë hetimit administrativ dhe paraqitja e tij nga subjekti i rivlerësimit, pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ, ngre dyshime për vërtetësinë e këtij dokumenti, si dhe për mënyrën e likuidimit të vlerës *cash* prej 83.000 euro nga nëna e subjektit në vitet 2007 - 2008 të shoqëria, në kushtet kur kjo pagesë nuk mbështetet në ndonjë dokumentacion provues si kontratë, aktmarrëveshje, mandatarkëtim, transfertë bankare etj. Përpos sa më sipër, vetë kontrata e qirasë për këtë pasuri përcakton se pjesë përbërëse e saj do të jenë të gjitha lidhjet<sup>19</sup> të cilat i emërton specifikisht në përmbajtje të saj dhe “vërtetimi i pagesës” i lëshuar nga administratori i shoqërisë nuk përmendet si pjesë e kontratës. Në këto kushte, pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim se vërtetimi për pagesat e kryera u lëshua për faktin se nuk u arrit të gjendeshin faturat për pagesat e kryera në vitet 2007 dhe 2008, duke qenë se kishte kaluar afati ligjor për ruajtjen e tyre, mbetet deklarativ, pasi askush nuk do t’i pengonte palët kontraktore që me vullnetin e tyre të lirë të parashikonin në kontratë mënyrën e likuidimit të shumës apo të përcaktonin si pjesë të saj dhe vërtetimin e pagesës.

**33.5.** Për sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie, mbetet i paprovuar me dokumentacion justifikues ligjor pretendimi i subjektit të rivlerësimit se për shlyerjen e detyrimit të kontratës së qirasë për dy pagesat në vitin 2007 dhe 2008 në vlerën 83.000 euro, nëna e subjektit të rivlerësimit kishte përdorur shumën prej 90.000 eurosh dhënë nga z. V. I.. Aq më tepër kur transaksionet e tjera mes nënës së subjektit të rivlerësimit dhe z. I., si administrator i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, janë kryer nëpërmjet sistemit bankar, si kthimi i shumës 160.000 euro paguar nga babai i subjektit të rivlerësimit për blerje dyqani, ashtu edhe pagesa për blerjen e apartamentit në “{\*\*\*}”, Tiranë. Ndërsa sa i përket likuidimit të shumës 16.600 euro, transferuar nga llogaria bankare e nënës së subjektit te ajo e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, e cila buron nga shuma 160.000 euro, trupi gjykues vlerëson të ndalet në evidentimin e fakteve të rezultuara nga aktet në dosjen gjyqësore, si dhe në analizimin e shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit.

**33.5.1.** Komisioni në vendim, për shumën 160.000 euro, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të rezultuara nga hetimi, duke e konsideruar subjektin e rivlerësimit trashëgimtar ligjor të babait, për pasojë edhe të pjesës takuese në pasurinë e përfutur pas vdekjes së tij, si dhe duke gjetur të dyshimtë transfertën bankare mes nënës së subjektit dhe znj. V. P., në përfundim,

---

<sup>18</sup> “Certificato di pagamento”.

<sup>19</sup> Lidhjet bashkëlidhur kontratës: lidhja 1: planimetria e përgjithshme; lidhja 2: planimetria e vendbarkës; lidhja 3: lista e shërbimeve portuale; lidhja 4: planimetria e godinave; lidhja 5: planimetria e apartamentit; lidhja 6: rregullorja e administrimit; si dhe lidhja 7: statuti i shoqatës “{\*\*\*}”, Orikum.

vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklaram të saktë në përputhje me ligjin dhe se nuk ka mundur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, prandaj ndaj tij duhet të zbatohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

**33.5.2.** Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, si të pabazuar në prova, duke pretenduar në ankim se: (i) përpjekja për t'i konsideruar prindërit persona të lidhur, duke i adresuar një trashëgimi hipotetike, nuk është aspak ligjore. Dëshmia e trashëgimisë përcakton subjektin si trashëgimtar, por nuk përcakton pasuritë e trashëguara. Mund të konsiderohet përfitues i një pasurie nëpërmjet trashëgimisë vetëm nëse pasuria efektivisht ka kaluar në pronësi të subjektit ose të paktën të jetë në emër të trashëgimlënësit në momentin e çeljes së trashëgimisë; (ii) transaksioni mes nënës dhe znj. V. P., për një shumë që nuk i përket subjektit, nuk e bën atë person tjetër të lidhur për efekt të këtij ligji. Të tillë nuk të bën as miqësia me znj. P.; (iii) subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në dijeni të gjithë transaksioneve bankare dhe njohja me to është bërë vetëm nëpërmjet materialeve të dërguara nga Komisioni me pyetësorët; (iv) kur shumat nuk i përkasin atij, pohimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka bashkëpunuar me të, duke mos depozituar dokumentacion dhe duke mos dhënë shpjegimet e kërkuara, është i pabazuar; (v) pavarësisht argumenteve të dhëna, Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit pa bërë asnjë kundërarargumentim (me prova) se përse nuk i merren parasysh këto argumente dhe përse ato të Komisionit prevalojnë. Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues, konstaton se:

**33.5.3.** Referuar akteve të administruara<sup>20</sup> nga Komisioni, në kuadër të hetimit administrativ, mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK përfaqësuar nga ortaku i vetëm dhe administratori V. I. dhe z. F. O. në cilësinë e porositësit, nënshkruhet kontratë sipërmarrje (jo noteriale) më datë 11.02.2010, me objekt njësi (dyqan) me sipërfaqe totale 198 m<sup>2</sup> të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, në vlerën 160.000 euro, shumë e likuiduar *cash* me 6 (gjashtë) këste nga babai i subjektit të rivlerësimit pranë shoqërisë, për të cilat janë lëshuar mandatarkëtimet<sup>21</sup>. Më datë 25.06.2011, palët me marrëveshje mes tyre revokuan kontratën e sipërmarrjes dhe ranë dakord për të kthyer shumën 160.000 euro nëpërmjet bankës, shumë e cila, për shkak të mungesës së likuiditetit të shoqërisë, do të paguhej brenda vitit 2014 në llogarinë bankare të porositësit. Më datë 11.07.2011 ndërron jetë babai i subjektit të rivlerësimit dhe me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.12.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë lëshon dëshminë e trashëgimisë, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit është një nga dy trashëgimtarët ligjorë të z. F. O.. Në deklaratën noteriale<sup>22</sup> të datës 12.02.2015, administratori i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, z. V. I., deklaron se e ka shlyer të gjithë shumën 160.000 euro nëpërmjet bankës në llogarinë e bashkëshortes së të ndjerit F. O., znj. E. O..

<sup>20</sup> Përcjellë nga “Banka Kombëtare Tregtare” ShA nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 13.04.2021 dhe nga noterja F. M. me shkresën e datës 19.04.2021.

<sup>21</sup> Mandatarkëtimet: (1) nr. {\*\*\*}, datë 11.02.2010, shuma 30.000 euro, “Pagesë për blerje dyqani, kësti i parë”; (2) nr. {\*\*\*}, datë 11.03.2010, shuma 20.000 euro, “Kësti i dytë për blerje dyqani”; (3) nr. {\*\*\*}, datë 15.06.2010, shuma 30.000 euro, “Pagesë për blerje dyqani kësti i tretë”; (4) nr. {\*\*\*}, datë 11.09.2010, shuma 20.000 euro, “Pagesë për blerje dyqani kësti i katërt”; (5) nr. {\*\*\*}, datë 11.12.2010, shuma 30.000 euro, “Pagesë për blerje dyqani kësti i pestë”; si dhe (6) nr. {\*\*\*}, datë 11.04.2011, shuma 30.000 euro, “Pagesë për blerje dyqani kësti i gjashtë”.

<sup>22</sup> Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 12.02.2015.

**33.5.4.** “Banka Kombëtare Tregtare” ShA<sup>23</sup> informon Komisionin se znj. E. O. ka pasur pranë kësaj banke një llogari rrjedhëse dhe dy llogari kursimi në monedhën euro, njëren prej tyre të çelur më datë 08.05.2015 e ka pasur të përbashkët me znj. V. P.. Referuar lëvizjeve të llogarisë rrjedhëse të znj. E. O., në BKT ShA, rezulton që më datë 12.02.2015 të jetë kredituar shuma 160.000 euro e transferuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, me përshkrimin “{\*\*\*}” ShPK për E. T. O. kthim fondi për prishje kontrate për blerje dyqani, sipas deklaratës noteriale, datë 12.02.2015, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol.”. Më datë 08.05.2015, znj. E. O. transferon në llogarinë e saj të kursimit shumën 100.000 euro dhe në llogarinë e kursimit të përbashkët me znj. V. P. shumën 60.000 euro, shumë e cila më datë 27.11.2015 është transferuar nga znj. P. në llogarinë e saj personale të kursimit, në po të njëjtën bankë. Ndërsa nga llogaria e saj e kursimeve në shumën 100.000 euro, më datë 27.11.2015, znj. E. O. transferon shumën 16.600 euro te shoqëria “{\*\*\*}” ShPK me përshkrimin “Pagesë për marrje me qira të apartamentit” dhe nga balanca e mbetur prej 83.400 eurosh, më datë 20.06.2018, transferon 80.000 euro me përshkrimin “Për “{\*\*\*}” ShPK sa kaluar, sipas kontratë porosie nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.06.2018”, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 134 m<sup>2</sup>, në “{\*\*\*}”, Tiranë, që do të trajtohet në vijim në këtë vendim.

**33.5.5.** Gjatë hetimit administrativ, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime lidhur me transaksionin 160.000 euro nga prishja e kontratës me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK për blerje dyqani dhe dokumentacion provues mbi burimin e krijimit të kësaj shume, arsyet e transferimit të shumës 60.000 euro nga nëna e subjektit të rivlerësimit te znj. V. P., si dhe lidhjen mes tyre. Në këtë drejtim, subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e datës 13.04.2021, ka sqaruar se asnjë nga transaksionet, kontratat apo sendet e paluajtshme të kontraktuara nga prindërit e tij nuk kanë lidhje me të, nuk bëjnë pjesë në pasuritë e deklaruara apo të poseduara prej tij dhe, rrjedhimisht, nuk disponon dokumente lidhur me to. Ndërsa lidhur me znj. V. P., në përgjigjet e datës 20.04.2021, subjekti i rivlerësimit deklaroi se me të ka pasur shoqëri dhe miqësi familjare dhe transaksioni bankar i vitit 2015 është kryer nga nëna dhe se ai është vënë në dijeni të këtij transaksioni nga e-mail i Komisionit dhe nuk lidhet me likuiditete që i përkasin atij.

**33.5.6.** Me rezultatet e hetimit administrativ, për shkak të transaksionit të mësipërm, Komisioni ka vlerësuar se mes subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të tij ka pasur lidhje interesi dhe, për këtë shkak, i konsideron ata persona të tjerë të lidhur, sipas nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016<sup>24</sup>. Për këtë arsye, Komisioni i kalon subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi, sipas Komisionit, duket se subjekti i rivlerësimit fsheh blerjen e njësisë dhe transaksionet bankare të kryera dhe ngre dyshimin që janë pasuri të fshehura të subjektit, i cili dhe në cilësinë e trashëgimitarit ligjor të pasurive të babait duhet të deklaronte në deklaratën periodike vjetore 2015, pjesën takuese për këtë pasuri.

**33.5.7.** Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit shprehet se nuk i konsideron prindërit persona të lidhur apo persona të tjerë të lidhur për efekt të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka pasur asnjë marrëdhënie interesi mes tij dhe tyre. Përveç vështirësisë objektive (pasi pasuritë u përkasin atyre, si dhe për faktin se babai ka ndërruar jetë), subjekti i

<sup>23</sup> Me shkresat nr. {\*\*\*} prot., datë 05.02.2020 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 05.05.2021.

<sup>24</sup> Neni 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, parashikon: ““Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi”.

rivlerësimit pretendon se nuk ka detyrim ligjor për të provuar mënyrën dhe burimet e krijimit të pasurive që u përkasin prindërve të tij. Megjithatë, për të hequr çdo dyshim, ai shprehet se e ndjen detyrim moral ndaj tyre dhe shpjegon se në dijeninë e tij, të ardhurat kanë qenë për babain nga puna si inxhinier elektrik në shtet, përkthyes librash, shkrimtar librash dhe artikuj shkencore, lojtar, trajner dhe arbitër shahu me titullin mjeshtrë sporti, konsulenca private në fushën e inxhinierisë elektrike, pensioni, dëshmipërblim për të përndjekurit politike dhe paratë që ka dërguar herë pas here subjekti i rivlerësimit gjatë kohës së emigracionit, si dhe të ardhurat për nënën kanë qenë nga puna e saj si dentiste në shtet për rreth 41 vjet, nga pensioni dhe puna si dentiste privatisht nga viti 1991 deri në vitin 2004. Për të provuar të ardhurat e prindërve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetime mbi pensionin e pleqërisë së tyre lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Sigurimeve Shoqërore, ndërsa për të ardhurat nga aktivitetet e ushtruara prej tyre privatisht, ai shprehet se nuk është në gjendje të paraqesë dokumentacion, pasi prindërit nuk kanë qenë të regjistruar në organet tatimore për aktivitetin e ushtruar.

**33.5.8.** Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 160.000 euro, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion provues për të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit privat të nënës dhe babait të tij, me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit depozitoi analizë financiare për të cilën shprehet se është bërë me konsulencë të një eksperti kontabël. Në këtë analizë financiare, për periudhën 1991-2004, janë përlllogaritur në mënyrë hipotetike të ardhura nga puna si dentiste e nënës në vlerën 80.000 euro, ndërsa për periudhën 1993-2010, janë përlllogaritur të ardhura të babait si konsulent/projektim të sistemeve elektrike, në vlerën 45.000 euro.

**33.5.9.** Në kushtet kur sipas dëshmisë së trashëgimisë lëshuar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.12.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, subjekti i rivlerësimit dhe nëna e tij ishin trashëgimtarët ligjorë me 50 % pjesë takuese të pasurisë së babait, subjektit të rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore i është kërkuar nga Komisioni qëndrimi i tij lidhur me shumën 160.000 euro transferuar në llogari të nënës nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit është shprehur se nuk është në dijeni nëse kjo shumë ka qenë e të dy prindërve apo ka qenë e nënës, që realisht ka punuar më tepër se babai. Kjo shumë, sipas subjektit të rivlerësimit, mund të jetë edhe nga kursime të nënës përdorur nga babai për blerjen e njësisë në vitin 2010, pavarësisht se kontrata e sipërmarrjes dhe mandatarkëtimet janë nënshkruar nga babai.

**33.5.10.** Në analizë të pretendimeve të subjektit në ankim, trupi gjykues vlerëson se në zbatim të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 21.12.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, si trashëgimtar ligjor i gjysmës së pasurisë së trashëgimlënësit, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë në deklaratën periodike vjetore 2015, ½ pjesë takuese të shumës 160.000 euro të kthyer nga shoqëria në llogarinë bankare të nënës së tij, përfituar nga trashëgimia, në kushtet kur nuk rezulton që të ketë hequr dorë prej saj. Mospërmbushja e këtij detyrimi ligjor demonstroi qëllim për shmangien e kësaj shume nga kontrolli i ILDKPKI-së, qasje të cilën subjekti i rivlerësimit e vijon edhe gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, nëpërmjet shpjegimeve të pambështetura në akte, që nuk e kapërcejnë kufirin e deklaratives.

**33.5.11.** Në vlerësim të trupit gjykues është alogjike që shuma të konsiderueshme transferohen nëpërmjet llogarisë bankare të nënës së tij dhe subjekti i rivlerësimit të mos ketë dijeni dhe të

pretendojë marrjen informacion për to vetëm nëpërmjet komunikimeve elektronike me Komisionin në kuadër të hetimit administrativ, për më tepër kur subjekti i rivlerësimit ka jetuar në një banesë me nënën dhe nga ana tjetër konfirmon marrëdhënien miqësore me znj. P.. Qëndrimet e subjektit të rivlerësimit se nuk ka dijeni kujt i përket shuma 160.000 euro të dy prindërve apo nënës, që sipas tij ka punuar më tepër se babai dhe më pas se ato mund të jenë kursime të nënës të përdorura nga babai për blerjen e njësisë në vitin 2010, ndërkohë që nga aktet në dosje nuk rezultojnë që babai të jetë pajisur me prokurë apo akt përfaqësimi për të nënshkruar të gjitha transaksionet ligjore dhe financiare në vitin 2010 dhe 2011 lidhur me pasurinë njësi, vlerësohen nga trupi gjykues përpjekje për të krijuar konfuzion dhe për të fshehur pronësinë e vërtetë mbi këtë shumë.

**33.5.12.** Trupi gjykues gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit në vendim se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, duke qenë se dokumentacioni i depozituar në Komision për të ardhurat e prindërve ishte i pamjaftueshëm, pasi, sikurse deklaroi dhe vetë subjekti i rivlerësimit, aktivitetet e ushtruara nga prindërit nuk ishin të regjistruara në organet tatimore e, për rrjedhojë, edhe nëse këto të ardhura do të ekzistonin nuk do të plotësonin kërkesat e ligjshmërisë në kuptim të nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, për pagesën e detyrimeve tatimore. Për sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues vlerëson të pabazuara pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim dhe çmon se shuma 160.000 euro ka qenë një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit dhe, në këto kushte, afekton ligjshmërinë e pasurive të krijuara më pas nga nëna e subjektit të rivlerësimit që kanë këtë shumë si burim krijimi e, për rrjedhojë, i klasifikon ato si pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit.

**33.6.** Në vijim të këtij arsytimi, për pasurinë objekt shqyrtimi ndodhur në Orikum, Vlorë, duke mbajtur në konsideratë edhe rrethana të tjera si: (i) nëna e subjektit të rivlerësimit merr me qira një vendvarke, ndërkohë që ajo nuk disponon një mjet të tillë dhe subjekti kishte vetëm pak muaj që kishte blerë mjetin e lundrimit velierë; (ii) subjekti i rivlerësimit ka banuar dhe banon në të njëjtën adresë me prindërit e tij dhe aktualisht me nënën; (iii) në kushtet kur në përgjigjet e pyetësorit standard, deklaroi se për shkak të moshës së nënës është autorizuar prej saj të bëjë veprime në llogarinë e saj bankare në “Procredit Bank” ShA dhe “Raiffeisen Bank” ShA, por që deri aktualisht nuk ka kryer ndonjëherë veprime dhe, gjithashtu, është pajisur me prokurë për të tërhequr pensionin e saj nga sigurimet shoqërore, ndërkohë që nga ana tjetër shprehet se nuk ka pasur dijeni për transaksionet bankare të kryera nga nëna, në vlerësim të trupi gjykues tregojnë qartë që subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i sigurt në deklaratimet e tij dhe pasuritë apartament i përfituar me kontratë qiraje, vendvarke dhe shërbime portuale në Orikum, Vlorë janë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, situatë që e vendos atë në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

*Për pasurinë apartament me sipërfaqe totale 134,40 m<sup>2</sup> ndodhur në “{\*\*\*}”, Tiranë*

34. Për këtë pasuri, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pikës 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “c”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
35. Subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë konkluzion të Komisionit, si të pambështetur në prova, me pretendimet se: (i) Komisioni nuk argumenton se mbi cilat nga faktet e renditura në vendim

arrin në përfundimin se subjekti fsheh pjesën e tij takuese në këtë pasuri, përpiqet të shmangë dhënien e shpjegimeve lidhur me burimin e krijimit të saj, si dhe mbi cilat prova vërteton se subjekti ishte në dijeni të krijimit të kësaj pasurie; (ii) Komisioni nuk argumenton se përse çmimi favorizues i blerjes së këtij apartamenti lidhet me subjektin e rivlerësimit; (iii) Komisioni nuk jep asnjë argument se në çfarë mënyre origjina e të ardhurave të përdorura, moshja e nënës së subjektit dhe çmimi i shitjes së kësaj pasurie, provojnë se është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit; (iv) nuk mund të konsiderohet argument ligjor pohimi hipotetik i Komisionit se nga hetimi duket se kjo pasuri i takon subjektit të rivlerësimit në masën 50% dhe se do të jetë trashëgimtar i kësaj pasurie në vijim, pasi askush nuk mund ta dijë çfarë do të ndodhë në vijim se cili do të jetë trashëgimtar i kujt; (v) askush nuk mund të fshehë një pasuri, të kryejë transaksione që do të çonin në zbulimin e kësaj pasurie, pikërisht gjatë kohës së rivlerësimit; (vi) Komisioni nuk bën asnjë argumentim (me prova) se përse nuk merren parasysh argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të barrës së provës.

36. Nga analizimi i akteve të dosjes së Komisionit, trupi gjykues konstaton se:

36.1. Pasuria objekt shqyrtimi është përfituar me kontratën e porosisë (për ndërtim apartamenti) nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.06.2018, të nënshkruar mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK në cilësinë e palës sipërmarrëse dhe porositëses E. O., me objekt blerjen e apartamentit me sipërfaqe totale 134,40 m<sup>2</sup>, në vlerën 80.000 euro, ndodhur te {\*\*\*}, “{\*\*\*}”, Tiranë. Bashkëlidhur kontratës është administruar mandati i transferimit të shumës 80.000 euro nga llogaria bankare e nënës së subjektit të rivlerësimit tek ajo e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, më datë 20.06.2018.

36.2. Si përmendur në paragrafin 33.5.4 të këtij vendimi, shuma prej 80.000 eurosh origjinon nga shuma 160.000 euro, të cilën e njëjta shoqëri, “{\*\*\*}” ShPK, transferoi në emër të znj. E. O., sipas deklaratës noteriale të datës 12.02.2015, pas revokimit të kontratës së sipërmarrjes, datë 25.06.2011, për dyqanin e porositur me sipërfaqe totale 198 m<sup>2</sup> në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë.

36.3. Përsa i përket çmimit të porositjes së apartamentit prej 80.000 eurosh, Komisioni në vendim e ka konsideruar dukshëm më të ulët në raport me çmimin mesatar referues prej 107.000 lekë/m<sup>2</sup> të përcaktuar në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 07.03.2018, të Këshillit të Ministrave “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, i ndryshuar, në zonën ku ndodhet apartamenti. Me këtë çmim mesatar reference, vlera e apartamentit do të rezultonte 14.380.800 lekë (134,40 m<sup>2</sup> x 107.000 lekë/m<sup>2</sup>).

36.4. Pavarësisht se pasuria është krijuar pas plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, ajo i është nënshtruar kontrollit të Komisionit, pasi ka pasur si burim krijimi shumën 160.000 euro, vlerësuar si pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, arsyetuar në paragrafët 33.5.8 deri 33.5.12 të këtij vendimi. Përpos kësaj, trupi gjykues nuk e konsideron logjike faktin që subjekti i rivlerësimit duke jetuar në një banesë me nënën (82 vjeç) të mos jetë në dijeni që ajo ka nënshkruar kontratën e porosisë për një apartament banimi me sipërfaqe 134 m<sup>2</sup>, në një nga zonat më të shtrenjta të qytetit të Tiranës, të përfituar me një çmim dukshëm më të ulët se çmimi i referencës së zonës. Trupi gjykues konsideron, gjithashtu, të drejtë konkluzionin e

Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime dhe nuk e ka bindur atë mbi të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me fshehjen e pasurisë, përpjekjen për të shmangur dhënien e shpjegimeve lidhur me burimin e krijimit të saj, çmimin favorizues krahasuar me çmimin mesatar referues, por është mjaftuar vetëm me shpjegimin se *të gjitha paratë e disponuara nga nëna i përkasin vetëm asaj dhe nuk kanë lidhje me personin tim*. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se apartamenti objekt shqyrtimi, pavarësisht se nuk mund të bëjë të zbatueshëm nenin 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, pasi parë në raport me deklaratën e pasurisë *vetting* është përfituar pas periudhës së rivlerësimit, përsëri është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit duke qenë se e ka origjinën nga shuma 160.000 euro e krijuar gjatë periudhës së rivlerësimit dhe e fshehur në këtë proces.

*Për pasuritë 2 (dy) vendparkime ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, kontraktuar nga babai i subjektit të rivlerësimit*

37. Komisioni vlerëson se subjekti rivlerësimit ka jetuar në një banesë me prindërit dhe se kjo marrëdhënie ishte realizuar prej babait të tij, përfaqësuar me prokurë nga bashkëshortja e subjektit shumë pak kohë përpara se babai të ndërronte jetë. Komisioni krijoi bindjen se subjekti rivlerësimit nuk ka qenë bashkëpunues dhe nuk e ka ndihmuar në hetimet lidhur me këto pasuri, të cilat pas vdekjes së babait duhet t’i kalonin 50% subjektit të rivlerësimit. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues se këto kontrata nuk ekzistojnë më, janë revokuar apo cili është statusi aktual i tyre dhe as nuk është përpjekur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit. Komisioni vlerëson se subjekti rivlerësimit ndodhet në kushtet e pikës 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjën “c”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
38. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit duke pretenduar në ankim se dyshimi i Komisionit lidhur me kontratën premtim shitje për këto pasuri është absolutisht i gabuar, paragjykes dhe tendencioz. Komisioni nuk përmend se çfarë dokumenti provues duhet të paraqesë subjekti i rivlerësimit për diçka që nuk ekziston. Pa asnjë argument, Komisioni shprehet se ka krijuar bindjen që subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë bashkëpunues dhe nuk ka ndihmuar lidhur me këto pasuri, rrethana të cilat nuk ekzistojnë. Komisioni jep konkluzione të pambështetura në prova dhe pavarësisht argumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit konkludon se ai nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, pa arsyetuar me prova se përse nuk merren parasysh argumentet e dhëna nga subjekti dhe përse ato që pohon Komisioni duhet të konsiderohen të mirëqena.
39. Nga analizimi i akteve të dosjes së Komisionit lidhur me këto pasuri, trupi gjykues konstaton si vijon:
  - 39.1. Kjo pasuri është përfituar nëpërmjet kontratë premtim shitje (prenotim, dorëzim, 2 (dy) vendparkime) nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 10.06.2011, të nënshkruar mes palës shitëse të ardhshme shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe palës blerëse të ardhshme, z. F. O., përfaqësuar, me prokurë të posaçme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.02.2011, nga znj. Xh. O.<sup>25</sup>, me objekt 2 (dy) vendparkime në katin (-1) nëntokë, në objektin e ndërtuar nga shoqëria në rrugën

<sup>25</sup> Referuar prokurës së posaçme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.02.2011, përfaqësuesja znj. Xh. O., ka të drejtë dhe kompetencë të plotë të nënshkruajë çdo akt noterial për blerjen e këtyre dy vendparkimeve deri në kontratën përfundimtare të shitblerjes, si dhe të kryejë pagesat përkatëse për blerjen e këtyre vendparkimeve.

“{\*\*\*}”, Tiranë, kundrejt çmimit prej 1.400.000 lekësh secili, në total 2.800.000 lekë. Referuar përmbajtjes së kontratës, palët kanë rënë dakord që pala blerëse ka të drejtë t’i posedojë dhe shfrytëzojë vendparkimet sipas destinacionit, kurse kontrata përfundimtare e shitjes do të lidhet pas regjistrimit të pasurisë në favor të palës shitëse pranë ZVRPP-së Tiranë. Në kushtet e kontratës parashikohet se shuma prej 2.800.000 lekësh do të likuidohet nëpërmjet bankës pas nënshkrimit të kontratës dhe në rast se kontrata e shitjes pas regjistrimit të pasurisë në favor të palës shitëse të ardhshme nuk do të realizohet për faj të saj, kjo e fundit detyrohet t’i kthejë palës blerëse të ardhshme shumën e paguar, si dhe një penaltitet të barabartë me 50% të çmimit.

**39.2.** Gjatë hetimit administrativ, kërkesës së Komisionit për të provuar me dokumentacion burimin e të ardhurave të babait të tij për blerjen e kësaj pasurie, depozitimin e kontratës së blerjes dhe dokumentacionin përkatës për pagesën e kryer, subjekti i rivlerësimit i përgjigjet se transaksioni, kontrata dhe sendi i paluajtshëm nuk kanë lidhje me të, nuk bën pjesë në pasuritë e deklaruara apo poseduara prej tij dhe, rrjedhimisht, nuk ka dokumente. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit sqaron se nuk ka qenë në dijeni të kësaj kontrate. Pasi ka pyetur ish-bashkëshorten, ishte informuar prej saj se ishte paraqitur një okazion nga një klient i saj në kohën që punonte si avokate, por përfundimisht kontrata e shitjes nuk u krye dhe nuk pati asnjë kalim pronësie të garazheve në fjalë, te babai.

**39.3.** Me konsideratë faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ në Komisioni, si: (i) mospasja e një automjeti në pronësi <sup>26</sup> nga z. F. O.; (ii) mosha e tij relativisht e madhe 78 vjeçare kur ka porositur dy vendparkimet, arsye që shpjegon dhe përfaqësimin me prokurë nga ish-bashkëshortja e subjektit për nënshkrimin e kontratës; (iii) jetesa e subjektit të rivlerësimit në një banesë me babain, në vlerësim të trupit gjykues mbështesin konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk e ka ndihmuar atë në hetimet lidhur me këto pasuri, si dhe nuk është përpjekur të provojë të kundërtën e barrës së provës, duke u mjaftuar me deklarimin se nuk ka pasur padijeni për këtë kontratë apo se i është drejtuar ish-bashkëshortes për informacion lidhur me të. Në cilësinë e trashëgimtarit ligjor të fituar po atë vit, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor për të deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2011 të gjitha pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas parashikimit të nenit 4, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, përfituar nga trashëgimia ligjore.

**39.4.** Subjekti i rivlerësimit, edhe pse deklaroi se nuk pati asnjë kalim pronësie të vendparkimeve, për të qenë bindës para Komisionit, duhet të kishte depozituar dokumentin e revokimit të kontratës së premtim shitjes. Në kushtet kur ky akt nuk është depozituar, si dhe nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk u paraqit asnjë provë për statusin që kanë aktualisht këto pasuri apo kthimin e shumës së paguar prej 2.800.000 lekësh, nuk provohet në asnjë mënyrë tjetër që kontrata është revokuar dhe mbetet në fuqi vullneti i palëve i pasqyruar në kontratën premtim shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 10.06.2011, për pasojë të drejtat e krijuara prej saj pas çeljes së trashëgimisë ligjore duhet të ishin deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore 2011 dhe deklaratën e pasurisë *vetting*. Mosdeklarimi e vendos

---

<sup>26</sup> Konfirmuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 07.12.2020.



subjektin e rivlerësimit në kushtet e fshehjes së pasurisë, parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

40. Për pasuritë e kontraktuara nga prindërit, qëndrimi vetpërgjyeshues i subjektit të rivlerësimit nga detyrimi ligjor për deklarimin dhe justifikimin e burimit të ligjshëm të tyre, shkujdesja apo mungesa e vëmendjes, në raport me faktet dhe rrethanat e krijimit të tyre, në vlerësim të trupit gjykues kanë pasur për qëllim fshehjen e këtyre pasurive nga efektet e procesit të rivlerësimit.

*Për analizën financiare*

41. Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën (-) 22.375.501 lekë për të justifikuar krijimin e pasurive dhe shpenzimet e tij në raport me të ardhurat e ligjshme të konsideruara nga Komisioni.

42. Nga analizimi i vendimit të Komisionit, trupi gjykues konstaton se diferenca negative përfshin mungesën e burimeve financiare të ligjshme për periudhën 10.11.1997-2003 në vlerën (-) 14.161.253 lekë dhe pamjaftueshmërinë financiare për periudhën 2004-2016 në vlerën (-) 8.214.248 lekë, pa përfshirë në analizën financiare pasuritë e prindërve të subjektit të rivlerësimit, për të cilat Komisioni ka konkluduar se janë pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit.

42.1. Trupi gjykues i Kolegjit, në përgjigje të pretendimit të subjektit të rivlerësimit për përlogaritje të gabuara nga Komisioni, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, kontrollon analizën financiare të kryer prej tij dhe konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 14.212.321 lekë për periudhën nëntor 1997-31.12.2003, pa konsideruar të ardhurat nga punësimi i tij në emigracion dhe në shumën (-) 4.165.572 lekë për periudhën 2004-2016, duke e konsideruar shumën 15.000 euro dhe 1.000.000 lekë dhënë bashkëshortes për shkak të divorcit si detyrim të paguar nga gjendja e likuiditetit. Në këto kushte, totali i diferencave negative rezulton në vlerën (-) 18.377.893 lekë, ndërsa në rast se analiza financiare kryhet duke reflektuar të njëjtat qëndrime me Komisionin, duke konsideruar pagesën e shumës 15.000 euro dhe 1.000.000 lekë si shpenzime, jo të paguara nga likuiditeti gjendje i subjektit të rivlerësimit, totali i mungesës së burimeve financiare të ligjshme rritet në vlerën (-) 20.473.693, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

43. Në përfundim, trupi gjykues në Kolegj, mbështetur në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe çmon se vendimi nr. 412, datë 06.07.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet lënë në fuqi.

**PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 412, datë 06.07.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Kreshnik Omari.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 05.10.2023.

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*